



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. __, datë __. __. 2025

PËR

**NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË FITUARA NË SHTETET
ANËTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN, ZONËS EKONOMIKE EVROPIANE DHE
KONFEDERATËS SË ZVICRËS, SI DHE PËR VLERËSIMIN E
PROPORCIONALITETIT TË RREGULLAVE PËR AKSESIN DHE USHTRIMIN E
PROFESIONEVE TË RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ¹**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

**TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

1. Objekti i këtij ligji është zbatimi i regjimit të Bashkimit Evropian për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, nëpërmjet rregullimit nga njëra anë, të njohjes nga autoritetet kompetente shqiptare (si shtet pritës) të kualifikimeve profesionale të fituara në Bashkimin Evropian, Zonën Ekonomike Evropiane dhe Konfederatën e Zvicrës, me qëllim ushtrimin e profesionit të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, dhe nga ana tjetër, nëpërmjet

¹ Ky ligj është përafruar me:

- direktivën 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, për njohjen e kualifikimeve profesionale, numri CELEX 32005L0036, botuar me Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian seria L, numri 255, datë 30.9.2005, faqja 22-142, ndryshuar me direktivën (BE) 2024/505 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shkurt 2024, numri CELEX 32024L0505, botuar me Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2024/505, datë 12.02.2024;
- direktivën (BE) 2018/958 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 28 qershor 2018 mbi një test proporcionaliteti përpara miratimit të rregullores së re të profesioneve, numri CELEX 32018L0958, botuar me Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian seria L, nr. 173, datë 9.7.2018, faqja 25-34.

përcaktimit të përgjegjësive të autoriteteve shqiptare (si shtet origjine) për mundësimin e njohjes së kualifikimeve profesionale të fituara në Republikën e Shqipërisë në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane dhe Konfederatës Zvicerane, me qëllim ushtrimin e profesionit të rregulluar në një nga këto shtete, si dhe rregullimin e zbatimit të vlerësimit të proporcionalitetit përpara miratimit të parashikimeve ligjore, lidhur me aksesin dhe ushtrimin e një profesioni të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj përcakton:

- a) Parashikime ligjore në lidhje me kualifikimet profesionale për ofrimin e shërbimeve në mënyrë të përkohshme dhe rastësore në Republikën e Shqipërisë, nga shtetas që zotërojnë kualifikime profesionale të fituara në një shtet anëtar të BE-së, shtet anëtar të ZEE-së, Konfederata e Zvicrës;
- b) rregullat dhe procedurat për aksesin në ushtrimin e pjesshëm të një profesioni të rregulluar;;
- c) rregullat dhe procedurat për njohjen e praktikës profesionale të kryer në një shtet anëtar të BE-së, në një shtet anëtar të ZEE-së ose në Konfederatën e Zvicrës.
- ç) Rregullat dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve profesionale të fituara në një shtet anëtar të BE-s, shtet anëtar të ZEE-së, Konfederata e Zvicrës për të ushtruar të drejtën e vendosjes në Republikën e Shqipërisë sipas:
 - i) sistemit të përgjithshëm të njohjes;
 - ii) sistemit të njohjes në bazë të përvojës profesionale;
 - iii) sistemit automatik të njohjes për profesionet sektoriale në bazë të harmonizimit të kushteve minimale të formimit;
 - iv) kuadrit të përbashkët të formimit;
- d) Rregullat dhe procedurat në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale në sajë të Kartës Evropiane Profesionale;
- dh) Rregullat dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve nga autoritetet kompetente shqiptare për mundësimin e njohjes së kualifikimeve profesionale të fituara në Republikën e Shqipërisë në një nga shtetet anëtare të BE-së, ZEE-së apo Konfederatës së Zvicrës;
- e) Rregullat për vlerësimin e proporcionalitetit përpara miratimit të parashikimeve ligjore, rregullatore ose administrative, të reja ose që ndryshojnë ato në fuqi, lidhur me aksesin dhe ushtrimin e një profesioni të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i lëvizjes së lirë dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve në Republikën e Shqipërisë të profesionistëve të kualifikuar që i kanë fituar kualifikimet profesionale në shtetet anëtare të BE-së, ZEE-së ose në Konfederatën e Zvicrës, si dhe të lehtësojë lëvizjen e

lirë të profesionistëve të kualifikuar që i kanë fituar kualifikimet profesionale në Shqipëri drejt shteteve anëtare të BE-së, ZEE-së dhe Konfederatës së Zvicrës.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për:
 - a) shtetasit e një shteti anëtar të BE-së, ZEE-së, ose shtetasit shqiptar;
 - b) që zotërojnë një kualifikim profesional të fituar në një shtet anëtar të BE-së dhe ZEE-së, që i mundëson aksesin dhe ushtrimin e profesionit në këtë shtet; dhe
 - c) që synojnë të aksesojnë dhe të ushtrojnë këtë profesion të rregulluar në Republikën e Shqipërisë si të punësuar ose të vetëpunësuar.
2. Ky ligj zbatohet edhe për shtetasit e parashikuar në paragrafin 1, nënparagrafin a) të këtij neni dhe për shtetasit e Konfederatës së Zvicrës, në lidhje me kualifikimet profesionale të fituara në Konfederatën e Zvicrës, për aq sa dhe në përputhje me marrëveshjet bilaterale të Konfederatës së Zvicrës me Bashkimin Evropian.
3. Ky ligj zbatohet edhe për shtetasit e një shtetit tjetër të ndryshëm nga shtetet anëtare të BE-së, ZEE-së dhe Konfederatës së Zvicrës, vetëm në rast se këta shtetas përfitojnë trajtim të barabartë sipas akteve ligjore të posaçme që bazohen në një akt të BE-së.
4. Ky ligj nuk zbatohet për shtetasit e parashikuar në paragrafin 1, nënparagrafin a) të këtij neni, në rast se kualifikimet profesionale i kanë fituar në një shtet të ndryshëm nga ato të parashikuara në paragrafin 1, nënparagrafin b) të këtij neni.
5. Ky ligj nuk zbatohet për profesionin e noterit, si dhe për profesionet e rregulluara për të cilat njohja e kualifikimeve profesionale bëhet në bazë të një akti ligjor të posaçëm që bazohet në një akt të BE-së që rregullon njohjen në mënyrë të veçantë.
6. Ky ligj zbatohet edhe për shtetasit e një shteti anëtar të BE-së ose shtetasit e një shteti të ZEE-së ose të Konfederatës Zvicerane që kanë ndjekur një praktikë profesionale në një vend të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arsim dhe formim i rregulluar” nënkupton çdo program formimi të hartuar posaçërisht për ushtrimin e një profesioni të caktuar dhe që përfshin një ose më shumë cikle studimi, të shoqëruara, sipas rastit, me formim profesional, periudhë prove ose praktikë profesionale. Struktura dhe niveli i formimit profesional, periudha e provës ose praktika profesionale përcaktohen nga dispozitat ligjore, nënligjore ose administrative të shtetit përkatës ose mbikëqyren apo miratohen nga autoriteti i caktuar për këtë qëllim.

2. “Arsye madhore interesit të përgjithshëm”, janë arsye të njohura si të tilla në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian;

3. “Autoriteti kompetent”, është çdo autoritet ose organ i ngarkuar posaçërisht nga Republika e Shqipërisë, një shtet anëtar i BE-së, ZEE-së ose nga Konfederata Zvicerane për të lëshuar ose pranuar dëshmi formimi dhe dokumente ose informacione të tjera, si dhe për të pranuar aplikime dhe për të marrë vendime, në përputhje me këtë ligj ose me dispozitat përkatëse të kësaj fushe në legjislacionin e atij shteti.

4. “Dëshmi të kualifikimeve formale”, është:

- a) diplomë, certifikatë ose çdo dëshmi tjetër të lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane ose Konfederatës së Zvicrës, i caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, nënligjore ose administrative të atij shteti, që vërteton përfundimin me sukses të formimit profesional të përfituar kryesisht në Bashkimin Evropian, Zonën Ekonomike Evropiane ose Konfederatën e Zvicrës; diploma, certifikata ose çdo dëshmi tjetër e lëshuar nga një autoritet shqiptar që vërteton përfundimin me sukses të një formimi profesional sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- b) diplomë, certifikatë ose çdo dëshmi tjetër të lëshuar nga një autoritet kompetent shqiptar, i caktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, që vërteton përfundimin me sukses të formimit profesional të përfituar kryesisht në Republikën e Shqipërisë;
- c) dëshmia e lëshuar nga një vend i tretë konsiderohet gjithashtu dëshmi e kualifikimeve formale, kur mbajtësi i saj ka ushtruar profesionin përkatës për të paktën tre vjet në territorin e një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane ose Konfederatës së Zvicrës, i cili e ka njohur këtë dëshmi në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar, dhe kur kjo përvojë profesionale është certifikuar nga autoriteti kompetent i atij shteti.

5. “Drejtues i një sipërmarrjeje”, është çdo person që, në një fushë të caktuar profesionale, ka ushtruar aktivitetin:

- a) si drejtues i një sipërmarrjeje ose i një dege të saj;
- b) si zëvendës i personit që zotëron sipërmarrjen ose i drejtuesit të sipërmarrjes, kur ky funksion përfshin përgjegjësi të barasvlershme me ato të personit që zotëron sipërmarrjen ose drejtuesit që përfaqësohet;
- c) në një funksion drejtues me detyra të natyrës tregtare dhe/ose teknike dhe me përgjegjësi për një ose më shumë departamente të sipërmarrjes. .

6. “Kartë Profesionale Evropiane (EPC)”, është një certifikatë elektronike që vërteton, sipas rastit:

- a) se profesionisti ka përmbushur të gjitha kushtet e nevojshme për të ofruar shërbime, në mënyrë të përkohshme dhe të rastësishme, në një shtet pritës; ose
- b) njohjen e kualifikimeve profesionale për qëllim vendosjeje në një shtet pritës.

7. “Kualifikime profesionale”, janë kualifikime të vërtetuara përmes dëshmive të kualifikimeve formale, një vërtetimi të kompetencave të referuar në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi a), nënparagrafi i) dhe/ose përvojës profesionale;

8. “Nomenklatura ISIC”, është një sistem klasifikimi i veprimtarive ekonomike i zhvilluar nga Departamenti i Statistikave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

9. “Periudhë e përshtatjes”, është një periudhë praktike e mbikëqyrur, gjatë së cilës profesionisti ushtron një profesion të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, nën përgjegjësinë e një anëtar të kualifikuar të atij profesioni. Kjo periudhë mund të shoqërohet, sipas rastit, me formim shtesë dhe i nënshtrohet një vlerësimi.

10. “Përvojë profesionale”, është ushtrimi efektiv dhe i ligjshëm i një profesioni të rregulluar në një shtet anëtar të BE-së, me kohë të plotë ose për një periudhë të barasvlershme me kohë të pjesshme.

11. “Praktikë profesionale”, është një periudhë ushtrimi të një profesioni të rregulluar nën mbikëqyrje, e cila përbën kusht për akses në ushtrimin e tij dhe që mund të zhvillohet gjatë ose pas përfundimit të arsimit që çon në pajisjen me diplomë.

12. “Profesion i rregulluar”, është një veprimtari profesionale, ose grup veprimtarish profesionale, për të cilat aksesimi, ushtrimi ose një nga format e ushtrimit është i kushtëzuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga zotërimi i kualifikimeve të posaçme profesionale, në bazë të dispozitave ligjore, nënligjore ose administrative. Në mënyrë të veçantë, konsiderohet si formë ushtrimi e një profesioni të rregulluar edhe përdorimi i një titulli profesional që, në bazë të legjislacionit në fuqi, është i rezervuar vetëm për personat që zotërojnë një kualifikim të caktuar profesional. Si profesione të rregulluara konsiderohen gjithashtu edhe ato që ushtrohen nga anëtarë të shoqatave ose organizatave të njohura në një formë të veçantë nga një shtet anëtar i BE-së, të cilat përcaktohen në nenin 99;

13. “Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve ose Kreditet ECTS”, është sistemi i krediteve për arsimin e lartë, i përdorur në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë;

14. “Sistemi i Informacionit të Tregut të Brendshëm/Sistemi IMI” (*Internal Market Information System - IMI*), një sistem elektronik komunikim shumëgjuhësh që lehtëson shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve publike të përfshira në zbatimin praktik të ligjit të Bashkimit Evropian, rregulluar nga Rregullorja (BE) Nr. 1024/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 mbi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm”;

15. “Shtet anëtar”, është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, shtet që ka nënshkruar Traktatin për Zonën Ekonomike Evropiane dhe Konfederata Zvicerane;

16. “Shteti anëtar i origjinës”, është shteti anëtar në të cilin individi ka fituar kualifikimin profesional për një profesion të rregulluar dhe i mundëson aksesin dhe ushtrimin në këtë shtet të këtij profesioni të rregulluar;

17. “Shtet anëtar pritës”, është shteti në të cilin individi kryen njohjen e kualifikimit profesional ose ofrimin e shërbimeve të përkohshme;

18. “Shtet i tretë” është çdo shtet që nuk është shtet anëtar;

19. “Shteti i vendosjes”, është shteti anëtar në të cilin shtetasi është i vendosur ligjërisht për qëllim të ndjekjes dhe ushtrimit të profesionit;

20. “Test i përshtatshmërisë”, është një provim që vlerëson njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale të aplikantit, me qëllim vlerësimin e aftësisë së tij për të ushtruar një profesion të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, në rast të dallimeve thelbësore midis kualifikimeve të tij dhe kërkesave të vendosura në legjislacionin shqiptar;

21. “Të nxënit gjatë gjithë jetës”, është procesi i të nxënit që zhvillohet gjatë gjithë jetës së individit dhe përfshin arsimin e përgjithshëm, arsimin dhe formimin profesional, arsimin joformal dhe të nxënit informal, që rezulton në përmirësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave, përfshirë, sipas rastit, edhe etikën profesionale;

22. “Titull profesional i mbrojtur”, është një formë e rregullimit të profesionit, ku përdorimi i titullit në një veprimtari profesionale, ose grup veprimtarish profesionale, është i kushtëzuar, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, në bazë të dispozitave ligjore, nënligjore ose administrative, nga zotërimi i kualifikimeve të posaçme profesionale, dhe kur përdorimi i parregullt i këtij titulli pasohet me sanksione;

23. “Veprimtari të rezervuara”, është një formë e rregullimit të një profesioni, ku aksesimi në një veprimtari profesionale ose në një grup veprimtarish profesionale u rezervohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në bazë të dispozitave ligjore, nënligjore ose administrative, anëtarëve të një profesioni të rregulluar që zotërojnë një kualifikim profesional specifik, përfshirë rastet kur veprimtaritë ndahen me profesione të tjera të rregulluara.

Neni 5

Efektet e njohjes së kualifikimeve profesionale

1. Njohja e kualifikimeve profesionale nga autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë i jep përfituesit të drejtën të aksesojë të njëjtin profesion në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të cilin ai është i kualifikuar në shtetin e tij të origjinës, dhe ta ushtrojë atë në të njëjtat kushte si shtetasit e kualifikuar në Republikën e Shqipërisë.

2. Për qëllimet e këtij ligji, profesioni që profesionisti dëshiron të ushtrojë në Republikën e Shqipërisë konsiderohet i njëjtë me atë për të cilin ai është i kualifikuar në shtetin e tij të origjinës, nëse veprimtaritë e përfshira në ushtrimin e profesionit janë të krahasueshme.

3. Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të jepet akses i pjesshëm në një profesion në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 6

Akresi i pjesshëm në ushtrimin e një profesioni të rregulluar

1. Autoriteti kompetent mund të japë akses të pjesshëm, rast pas rasti, në një veprimtari profesionale të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) profesionisti është plotësisht i kualifikuar për të ushtruar veprimtarinë përkatëse profesionale në shtetin e origjinës;
- b) dallimet ndërmjet veprimtarisë së ushtruar në mënyrë të ligjshme në shtetin e origjinës dhe profesionit të rregulluar në Republikën e Shqipërisë janë aq të mëdha, sa që zbatimi i masave kompensuese do të kërkonte ndjekjen e programit të plotë të arsimit dhe formimit të kërkuar në Shqipëri për akses të plotë në profesion;
- c) veprimtaria profesionale për të cilën kërkohet akses i pjesshëm mund të ndahet objektivisht nga veprimtaritë e tjera që përbëjnë profesionin e rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Për qëllimet e paragrafit 1, germa c), autoriteti kompetent merr parasysh nëse veprimtaria përkatëse ushtrohet në mënyrë autonome në shtetin anëtar të origjinës së aplikantit.

3. Autoriteti kompetent mund të refuzojë dhënien e aksesit të pjesshëm, nëse një refuzim i tillë është i justifikuar nga arsye madhore të interesit të përgjithshëm, është i përshtatshëm për të garantuar arritjen e objektivit të ligjshëm dhe nuk tejkalon atë që është e nevojshme për ta arritur atë.

4. Kërkesat për akses të pjesshëm për qëllime të vendosjes në Republikën e Shqipërisë shqyrtohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kreun II dhe VI të Titullit III të këtij ligji.

5. Kërkesat për akses të pjesshëm për qëllime të ofrimit të përkohshëm ose të rastësishëm të shërbimeve, nëse veprimtaria përkatëse ka implikime për shëndetin publik ose sigurinë, shqyrtohen në përputhje me Titullin II të këtij ligji.

6. Në përjashtim nga parashikimet e nenit 10, dhe nenit 17, paragrafi 1, profesionisti që përfiton nga akses i pjesshëm ushtron veprimtarinë përkatëse nën titullin profesional të shtetit të origjinës. Autoriteti kompetent mund të kërkojë që titulli profesional të përdoret në gjuhën shqipe. Profesionistët që përfitojnë nga akses i pjesshëm detyrohen të informojnë në mënyrë të qartë marrësit e shërbimit për shtrirjen e kufizuar të veprimtarisë së tyre profesionale.

7. Kjo dispozitë nuk zbatohet për profesionistët që përfitojnë nga njohja automatike e kualifikimeve profesionale, sipas Krerëve III, IV dhe V të Titullit III të këtij ligji.

TITULLI II

USHTRIMI I PËRKOHSHËM DHE I RASTËSISHËM I PROFESIONIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 7

E drejta për të ofruar shërbime në mënyrë të përkohshme dhe të rastësishme

1. Shtetasit e një shteti anëtar, kanë të drejtë të ushtrojnë një profesion të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, si të punësuar ose të vetëpunësuar, pa qenë e nevojshme të kryhet njohja

e kualifikimeve profesionale dhe pa u kufizuar nga arsye që lidhen me kualifikimet profesionale, nëse përmbushen njëherazi kushtet e mëposhtme:

- a) shtetasi është i vendosur ligjërisht në një shtet anëtar për ushtrimin e profesionit;
- b) shtetasi zhvendoset fizikisht në Republikën e Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve në lidhje me këtë profesion;
- c) shërbimet ofrohen në mënyrë të përkohshme dhe të rastësishme në Republikën e Shqipërisë, pa synimin për t'u vendosur; dhe
- ç) kur profesioni dhe arsimi ose formimi profesional përkatës nuk janë të rregulluara në shtetin anëtar të vendosjes, profesionisti e ka ushtruar atë profesion në një ose më shumë shtete anëtare për të paktën një vit gjatë dhjetë viteve që paraprijnë ushtrimin e profesionit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Një shtetas konsiderohet se është i vendosur ligjërisht në një shtet anëtar, në kuptim të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi a) nëse:

- a) përmbush të gjitha kushtet për ushtrimin e profesionit në shtetin e vendosjes;
- b) nuk është i ndaluar për ushtrimin e profesionit në shtetin e vendosjes.

3. Natyra e përkohshme dhe e rastësishme e shërbimeve, në kuptim të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi c), vlerësohet rast pas rasti nga autoriteti kompetent, pa vendosur kufij të paracaktuar për kohëzgjatjen ose frekuencën e shërbimit. Ky vlerësim bazohet veçanërisht në:

- a) kohëzgjatjen e aktivitetit profesional;
- b) shpeshtësinë;
- c) rregullsinë;
- ç) vazhdimësinë e ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 8

Deklarata paraprake për të ofruar shërbimin

1. Përpara ofrimit për herë të parë të shërbimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, profesionist paraqet një deklaratë me shkrim pranë autoritetit kompetent.

2. Deklarata përmban:

- a) të dhënat identifikuese të profesionistit, përfshirë emër, mbiemër, të dhëna kontakti, adresë dhe profesionin;
- b) titullin profesional dhe shtetin anëtar ku është marrë;
- c) qëllimin për të ofruar shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përshkrimin e shërbimeve që do të ofrohen;
- ç) informacion mbi sigurimin profesional ose mjete të tjera mbrojtëse, individuale apo kolektive, në lidhje me përgjegjësinë profesionale, përfshirë të dhënat e kontaktit për to.

3. Deklarata rinovohet një herë në vit nëse profesionisti ka ndërmend të vazhdojë të ofrojë shërbime në mënyrë të përkohshme ose të rastësishme në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë atij viti.

4. Deklarata mund të dorëzohet në çdo formë komunikimi të përshtatshme.
5. Parashtrimi i deklaratës në përputhje me këtë nen i jep profesionistit të drejtën për të ushtruar profesionin në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve të parashikuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 9

Dokumentet që shoqërojnë deklaratën

1. Për ofrimin për herë të parë të shërbimit, ose kur ndodhin ndryshime thelbësore në të dhënat e mëparshme, autoriteti kompetent mund të kërkojë që deklaratata të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) dëshmi të shtetësisë së profesionistit;
- b) vërtetim për vendosjen e ligjshme në një shtet anëtar për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, dhe për mungesën e ndalimit ose pezullimit, edhe të përkohshëm, të ushtrimit të profesionit në momentin e dorëzimit të vërtetimit;
- c) dëshmi të kualifikimeve profesionale;
- ç) për rastet kur profesioni nuk është i rregulluar në shtetin anëtar të vendosjes, dëshmi që vërteton ushtrimin e tij për të paktën një vit gjatë dhjetë viteve të fundit;
- d) për profesionet në sektorin e sigurisë, në sektorin e shëndetësisë dhe në fushën e edukimit të të miturve (përfshirë edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme), një vërtetim për mungesën e dënimeve penale dhe të pezullimeve, përfundimtare ose të përkohshme, nga ushtrimi i profesionit, nëse kjo kërkohej për shtetasit shqiptarë;
- dh) për profesionet që kanë ndikim në sigurinë e pacientit, deklaratë mbi njohuritë e gjuhës së nevojshme për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë;
- e) për profesionet që nuk përfitojnë nga njohja automatike, dhe që përfshihen në fushën e veprimtarive të përcaktuara në sipas Kreut III, Titulli III i këtij ligji, të cilat janë njoftuar nga Republika e Shqipërisë në përputhje me nenin 96, paragrafi 1, nënparagrafi a), nënparagrafi iii) dhe nenin 96, paragrafi 1, nënparagrafi b), certifikatë që përmban të dhëna mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e ushtrimit të aktivitetit, e lëshuar nga autoriteti ose organi kompetent i shtetit anëtar të vendosjes.

Neni 10

Kontrolli paraprak i kualifikimeve profesionale

1. Për profesionet e rregulluara, autoriteti kompetent mund të kryejë një kontroll paraprak të kualifikimeve të profesionistit përpara ofrimit të parë të shërbimit, kur:

- a) qëllimi i kontrollit është të shmangë dëmtimin serioz të shëndetit ose sigurisë së përfituesit të shërbimit, për shkak të mungesës së kualifikimeve profesionale të ofruesit të shërbimit; dhe
- b) kontrolli nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për këtë qëllim.

2. Brenda një muaji nga marrja e deklaratës dhe dokumentacionit të parashikuar në nenet 8 dhe 9 të këtij ligji, autoriteti kompetent njofton profesionistin për vendimin:

- a) për të mos kryer kontrollin;
- b) për të lejuar ofrimin e shërbimit;
- c) për të kërkuar kryerjen e testit të aftësisë.

3. Nëse autoriteti përballlet me vështirësi që pengojnë marrjen e një vendimi brenda afatit të mësipërm, ai njofton profesionistin për arsyet e vonesës brenda të njëjtit afat. Vështirësia zgjidhet brenda një muaji nga data e njoftimit, dhe vendimi përfundimtar merret brenda dy muajve nga zgjidhja e vështirësisë.

4. Nëse autoriteti kompetent nuk reagon brenda afateve të përcaktuara, profesionisti ka të drejtë të fillojë ushtrimin e profesionit.

5. Kur konstatohet një diferencë thelbësore ndërmjet kualifikimeve të profesionistit dhe kërkesave të formimit në Republikën e Shqipërisë, e cila:

- a) është e tillë që mund të dëmtojë shëndetin ose sigurinë publike; dhe
- b) nuk mund të kompensohet nga përvoja profesionale apo njohuritë, aftësitë apo kompetencat e fituara nga të nxënit gjatë gjithë jetës, të certifikuara nga autoriteti kompetent ku këto janë fituar, profesionistit i jepet mundësia të dëshmojë zotërimin e kualifikimeve përkatëse nëpërmjet një testi përshtatshmërie,

Vendimi për lejimin e ushtrimit të profesionit merret mbi bazën e rezultateve të testit të përshtatshmërisë. Në çdo rast, ushtrimi i profesionit duhet të fillojë brenda një muaji nga marrja e këtij vendimi.

Neni 11

Përfashtime nga kërkesat për ushtrimin e përkohshëm dhe të rastësishëm të profesionit

1. Në përputhje me nenin 7 të këtij ligji, profesionisti që ushtron përkohësisht dhe rastësisht një profesion në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas kushteve të përcaktuara në këtë titull, përjashtohet nga kërkesat që zbatohen për profesionistët e vendosur në Republikën e Shqipërisë, që lidhen me:

- a) autorizimi nga një organizatë ose urdhër profesional, regjistrimi ose anëtarësimi në të.
- b) regjistrimin pranë një institucioni publik të sigurimeve shoqërore, për qëllime shlyerje të shpenzimeve me siguresin në lidhje me shërbimet e ofruara për përfitues të siguruar.

2. Me qëllim zbatimin e dispozitave disiplinore të parashikuara në nenin 12, paragrafi 1 të këtij ligji, autoriteti kompetent mund të parashikojë regjistrim të përkohshëm automatik ose anëtarësim *pro forma* të profesionistit në organizatën ose trupën profesionale përkatëse, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) regjistrimi ose anëtarësimi nuk vonon ose ndërlikon në asnjë mënyrë ofrimin e shërbimit nga profesionisti;
- b) regjistrimi ose anëtarësimi nuk sjell ndonjë kosto shtesë për profesionistin;

c) regjistrimi ose anëtarësimi kryhet automatikisht nga autoriteti kompetent dhe nuk i kërkohej profesionistit të ndërmarrë veprime shtesë administrative për këtë qëllim.

3. Për qëllimet e paragrafit 2 të këtij neni, autoriteti kompetent i dërgon organizatës ose trupës përkatëse profesionale një kopje të deklaratës paraprake dhe, sipas rastit, të rinovimit të saj, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

Kur profesionisti ushtron një profesion që:

a) ka ndikim në shëndetin dhe sigurinë publike, sipas nenit 10 të këtij ligji; ose

b) përfiton nga njohja automatike sipas Kreut IV të Titullit III të këtij ligji,

kësaj deklarate i bashkëlidhen edhe dokumentet përkatëse të parashikuara në nenin 9, paragrafi 1 të këtij ligji. Dërgimi i këtyre dokumenteve nga autoriteti kompetent përbën, për qëllimet e këtij neni, regjistrim të përkohshëm automatik ose anëtarësim *pro forma* të profesionistit në organizatën ose trupën përkatëse profesionale.

4. Profesionisti është i detyruar të informojë paraprakisht, ose në rast urgjence menjëherë pas përfundimit të shërbimit, institucionin përkatës të sigurimeve shoqërore për shërbimet e ofruara, në rastet e parashikuara në paragrafin 1, germa b të këtij neni.

Neni 12

Rregulla të zbatueshme gjatë ushtrimit të profesionit në mënyrë të përkohshme dhe rastësore

1. Profesionisti i nënshtrohet gjatë ushtrimit të profesionit në territorin e Republikës së Shqipërisë, rregullave profesionale, statutore ose administrative që lidhen drejtpërdrejt me kualifikimet profesionale, përfshirë ato që lidhen me:

a) përkufizimin e profesionit;

b) përdorimin e titujve profesionalë;

c) masat ndaj shkeljeve të rënda profesionale që lidhen posaçërisht me mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë publike;

ç) dispozitat disiplinore që zbatohen për profesionistët vendas.

2. Profesionisti ushtron profesionin nën titullin profesional të shtetit anëtar të vendosjes, nëse ekziston një titull i tillë për veprimtarinë përkatëse. Ky titull paraqitet në gjuhën zyrtare të shtetit anëtar të vendosjes, në mënyrë që të shmanget çdo konfuzion me titullin profesional përkatës të përdorur në Republikën e Shqipërisë. Nëse në shtetin anëtar të vendosjes nuk ekziston një titull profesional për veprimtarinë përkatëse, profesionisti përdor kualifikimin formal të tij, në gjuhën zyrtare të shtetit anëtar të vendosjes.

3. Profesionisti, që përfiton nga njohja automatike bazuar në kushtet minimale të formimit, sipas Kreut III dhe IV, Titulli III i këtij ligji, ose ka kaluar verifikimin paraprak të kualifikimeve sipas nenit 10, ushtron profesionin nën titullin profesional të përdorur në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Informacioni që i jepet përfituesit të shërbimit

1. Kur shërbimi ofrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenin 12, paragrafi 2 më sipër, nën titullin profesional të shtetit anëtar të vendosjes ose mbi bazën e kualifikimit formal, profesionisti informon përfituesin e shërbimit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qartë mbi një ose më shumë nga elementët e mëposhtëm:

- a) regjistrin tregtar ose publik në të cilin është i regjistruar profesionisti, si dhe numrin e regjistrimit ose mjetin tjetër të identifikimit të ngjashëm me të;
- b) emrin dhe adresën e autoritetit mbikëqyrës kompetent në shtetin anëtar të vendosjes, nëse ushtrimi i profesionit është i lidhur me autorizim;
- c) çdo shoqatë profesionale ose trupë të ngjashme në të cilën është i regjistruar profesionisti;
- ç) titullin profesional të përdorur, ose në mungesë të tij, kualifikimin formal të profesionistit dhe shtetin anëtar ku është lëshuar;
- d) numrin e identifikimit për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), nëse zbatohet, në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor;
- dh) informacion mbi mbulimin me sigurim për përgjegjësi profesionale ose mbi çdo mjet tjetër individual ose kolektiv mbrojtës në lidhje me këtë përgjegjësi.

2. Ky informacion i jepet përfituesit të shërbimit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme përpara ose gjatë ofrimit të shërbimit.

Neni 14

Bashkëpunimi administrativ

1. Në rast të dyshimeve të arsyeshme, autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë mund të kërkojë nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të vendosjes informacion të nevojshëm për:

- a) ligjshmërinë e vendosjes së profesionistit;
- b) sjelljen e mirë të tij;
- c) mungesën e masave disiplinore ose sanksioneve penale me natyrë profesionale.

2. Nëse autoriteti kompetent në Republikën e Shqipërisë kryen kontroll paraprak të kualifikimeve profesionale të profesionistit, ai mund të kërkojë nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të vendosjes informacion mbi përmbajtjen e arsimit dhe formimit të ndjekur nga profesionisti, në masën që është e nevojshme për të vlerësuar dallime të mundshme thelbësore që mund të kenë ndikim në shëndetin ose sigurinë publike.

3. Në rastet kur profesioni nuk është i rregulluar në shtetin anëtar të vendosjes, informacioni përkatës mund të kërkojë edhe nga qendrat e asistencës të përcaktuara në nenin 95 të këtij ligji.

4. Autoritetet kompetente shqiptare marrin masa për të siguruar shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për trajtimin e ankesave të paraqitura nga përfituesit e shërbimeve ndaj profesionistëve. Përfituesi njoftohet për rezultatin e shqyrtimit të ankesës.

14/1

Dëshmi për të drejtën e ushtrimit të profesionit

1. Profesionisti i vendosur në Republikën e Shqipërisë, që synon të ofrojë shërbime në mënyrë të përkohshme dhe të rastësishme në territorin e një shteti anëtar, ka të drejtë të pajiset nga autoriteti kompetent shqiptar me një dëshmi të së drejtës për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.

2. Dëshmia për ushtrimin e profesionit e lëshuar nga autoriteti kompetent vërteton që:

- a) profesionisti përmbush të gjitha kushtet për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit të zbatueshëm;
- b) profesionisti nuk ka asnjë ndalim në lidhje me ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.

TITULLI III

USHTRIMI I PROFESIONIT NË MËNYRË TË PËRHERSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR NJOHJEN NË RASTIN E VENDOSJES

Neni 15

Sistemet e njohjes

Njohja e kualifikimeve profesionale për qëllim të vendosjes në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhet sipas një prej sistemeve të mëposhtme:

- a) Sistemi i përgjithshëm i njohjes, i parashikuar në Kreun II të këtij Titulli, nëpërmjet vlerësimit të kualifikimit profesional të fituar në shtetin e origjinës në raport me kërkesat për kualifikimin profesional në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nivelet e kualifikimit;
- b) Sistemi i njohjes automatike mbi bazën e përvojës profesionale, i parashikuar në Kreun III të këtij Titulli;
- c) Sistemi i njohjes automatike nëpërmjet kushteve minimale të formimit për profesionet sektoriale, i parashikuar në Kreun IV të këtij Titulli;
- ç) Sistemi i njohjes automatike në bazë të kuadrit të përbashkët të formimit, i parashikuar në Kreun V të këtij Titulli.

Neni 16

Vendimmarrja për njohjen

1. Njohja e kualifikimit profesional për qëllim të vendosjes në territorin e Republikës së Shqipërisë bëhet nga autoriteti kompetent në bazë të kërkesës nga personi i interesuar.
2. Autoriteti kompetent është ministria që mbulon fushën përkatëse për një profesion të rregulluar.
3. Procedura e detajuar dhe dokumentet që paraqiten me kërkesën për njohjen për qëllim të vendosjes në Republikën e Shqipërisë përcaktohen në Kreun VI të këtij Titulli.

Neni 17

Përdorimi i titullit profesional pas njohjes

1. Nëse përdorimi i një titulli profesional që lidhet me një nga veprimtaritë e profesionit përkatës është i rregulluar në Republikën e Shqipërisë, profesionisti të cilit i është njohur e drejta për ushtrimin e profesionit të rregulluar sipas këtij Titulli përdor titullin profesional të përcaktuar në legjislacionin shqiptar për atë profesion dhe çdo initiale shoqëruese, sipas rastit.
2. Nëse profesioni në Republikën e Shqipërisë është i rregulluar nga një shoqatë ose organizatë sipas kuptimit të nenit 99, të këtij ligji, profesionisti të cilit i është njohur e drejta për ushtrimin e profesionit të rregulluar nuk mund të përdorë titullin profesional të lëshuar nga ajo shoqatë ose organizatë, apo formën e tij të shkurtuar, përveç rasteve kur vërtetohet se është anëtar i asaj shoqate ose organizate.
3. Shoqatat ose organizatat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni nuk mund të kufizojnë përdorimin e titullit profesional për shtetasit e shteteve anëtare që zotërojnë kualifikime profesionale të njohura sipas këtij ligji, përveçse në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

KREU II

SISTEMI I PËRGJITHSHËM I NJOHJES

Neni 18

Fusha e zbatimit të sistemit të përgjithshëm të njohjes

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për njohjen e kualifikimeve profesionale nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, në të gjitha rastet kur:
 - a) profesionisti kërkon njohjen për ushtrimin e një profesioni të rregulluar që nuk përfshihet në fushën e zbatimit të sistemeve të tjera të njohjes të përcaktuara në këtë titull;

- b) profesionisti kërkon ushtrimin e një aktiviteti profesional të bazuar në përvojë profesionale dhe i përfshirë në klasifikimet përkatëse, sipas kreut III të këtij titulli, por nuk përmbush kushtet e njohjes të përcaktuara për përvojën profesionale të kërkuar;
- c) profesionisti kërkon njohjen për ushtrimin e profesionit të mjekut, mjekut specialist, infermierit përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, stomatologut, stomatologut të specializuar, veterinerit, mamisë, farmacistit apo arkitektit, por nuk përmbush kushtet për përfitimin e të drejtave të fituara, për shkak të mungesës së përvojës profesionale efektive dhe të ligjshme në përputhje me kreun IV të këtij titulli;
- ç) profesionisti kërkon njohjen për ushtrimin e profesionit të arkitektit dhe zotëron një dëshmi të kualifikimit që nuk është përfshirë në listën e dëshmive të kualifikimit të pranuar për njohje sipas sistemit të njohjes automatike, sipas kreut IV të këtij titulli;
- d) profesionisti kërkon njohjen për ushtrimin e një specialiteti në profesionin e mjekut, infermierit përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, stomatologut, veterinerit, mamisë, farmacistit ose arkitektit, duke zotëruar një dëshmi të kualifikimit që vërteton përfundimin e formimit bazë për ushtrimin e profesionit, por që nuk përmbush kushtet për njohjen automatike të specialitetit, sipas kreut IV të këtij titulli. Në këto raste, njohja bëhet vetëm për qëllimin e ushtrimit të specialitetit dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë kre;
- dh) profesionisti kërkon njohjen për ushtrimin e një aktiviteti profesional si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm ose si infermier i specializuar, duke zotëruar një dëshmi të kualifikimit formal të fituar pas përfundimit të formimit për infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, sipas kreut IV të këtij ligji, kur në Republikën e Shqipërisë aktiviteti përkatës ushtrohet nga infermierë të specializuar pa formim si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm;
- e) profesionisti kërkon njohjen për ushtrimin e një aktiviteti profesional si infermier i specializuar pa formim si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, kur në Republikën e Shqipërisë aktiviteti përkatës ushtrohet nga infermierë përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, infermierë të specializuar pa formim si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm ose infermierë të specializuar që zotërojnë një dëshmi të kualifikimit formal si specialist të fituar pas përfundimit të formimit për infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, sipas kreut IV të këtij ligji;
- ë) profesionisti zotëron një dëshmi kualifikimi të fituar në një shtet të tretë, e cila është njohur nga një shtet anëtar në përputhje me procedurën përkatëse të njohjes dhe ka ushtruar profesionin në fjalë për një periudhë të pandërprerë prej të paktën tre vitesh në atë shtet, me përvojën e certifikuar nga autoriteti kompetent i atij shteti.

Neni 19

Nivelet e kualifikimeve profesionale

Për qëllimet e këtij kreu, kualifikimet profesionale klasifikohen sipas niveleve të mëposhtme:

1. **Niveli a)** – Vërtetim i kompetencës profesionale i lëshuar nga autoriteti kompetent i një shteti anëtar, i përcaktuar me legjislacionin e atij shteti, që dëshmon:
 - a) ndjekjen e një programi formimi që nuk përfundon me një certifikatë apo diplomë të përfshirë në nivelet b), c), ç) ose d);
ose
 - b) kalimin me sukses të një provimi të posaçëm pa ndjekur formim paraprak; ose
 - c) ushtrimin me kohë të plotë të profesionit në një vend anëtar për tre vjet të njëpasnjëshme ose ekuivalentin në kohë të pjesshme gjatë dhjetë viteve të fundit.
 - ç) përfundimin e arsimit të përgjithshëm fillor ose të mesëm që dëshmon njohuri të përgjithshme.
2. **Niveli b)** – Certifikatë që dëshmon përfundimin me sukses të arsimit të mesëm të përgjithshëm ose profesional apo teknik, e plotësuar, sipas rastit, me:
 - a) një program arsimit ose formimi profesional tjetër nga ai i përcaktuar në nivelin c); dhe,
ose
 - b) praktika profesionale e detyrueshme ose periudha e provës e kërkuar në shtetin anëtar përkatës
3. **Niveli c)** – Diplomë që dëshmon përfundimin me sukses:
 - a) të një programi formimi në nivel pas të mesëm, të ndryshëm nga ata të përshkruar në nënparagrafët ç) dhe d), me kohëzgjatje të paktën një vit me kohë të plotë ose ekuivalenti me kohë të pjesshme, hyrja në të cilin kërkon përfundimin me sukses të arsimit të mesëm të përgjithshëm të nevojshëm për pranimin në arsimin e lartë, ose përfundimin e një niveli të barasvlershëm të arsimit të mesëm të lartë, si dhe, nëse kërkohet, përfundimin e një formimi profesional shtesë;
ose
 - b) të arsimit dhe formimit të rregulluar ose të një formimi profesional me strukturë të posaçme për ushtrimin e një profesioni të rregulluar, që përmban kompetenca që shkojnë përtej atyre të nivelit të përcaktuar në nivelin b) të këtij neni, dhe që është i barasvlershëm me nivelin e formimit të përshkruar në nënparagrafin a), dhe që përgatit mbajtësin për një nivel të ngjashëm përgjegjësish dhe funksionesh profesionale, me kusht që diploma të shoqërohet me një vërtetim nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës që konfirmon këtë barasvlerë.
4. **Niveli ç)** – Diplomë që vërteton përfundimin me sukses të një formimi në nivel pas të mesëm me kohëzgjatje të paktën tre vjet dhe jo më shumë se katër vjet, ose një kohëzgjatje ekuivalente me kohë të pjesshme, që mund të shprehet gjithashtu me numër ekuivalent kreditesh ECTS,

pranë një universiteti, institucioni të arsimit të lartë ose një institucioni tjetër të një niveli të barasvlershëm, dhe, nëse kërkohet, përfundimin me sukses të një formimi profesional shtesë në lidhje me këtë cikël studimi.

5. **Niveli d)** – Diplomë që vërteton përfundimin me sukses të një formimi në nivel pas të mesëm me kohëzgjatje të paktën katër vjet, ose një kohëzgjatje ekuivalente me kohë të pjesshme, që mund të shprehet gjithashtu me numër ekuivalent kreditesh ECTS, pranë një universiteti, institucioni të arsimit të lartë ose një institucioni tjetër të një niveli të barasvlershëm, dhe, nëse kërkohet, përfundimin me sukses të një formimi profesional shtesë në lidhje me këtë cikël studimi.

Neni 20

Barasvlera e dëshmive të kualifikimit

1. Çdo dëshmi ose grup dëshmish të kualifikimit formal, të lëshuara nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar dhe që vërtetojnë përfundimin me sukses të një formimi të ndjekur në territorin e Bashkimit Evropian, me kohë të plotë ose të pjesshme, brenda ose jashtë programeve formale të arsimit ose formimit profesional, trajtohen nga autoriteti kompetent si të barasvlershëm me dëshmitë e përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji, për sa kohë që:

- a) ato njihen nga shteti anëtar i origjinës si dëshmi të një niveli të barasvlershëm me ato të përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji; dhe
- b) ato u japin mbajtësve të drejtën për të hyrë ose ushtruar një profesion të rregulluar ose i përgatisin për ushtrimin e tij në shtetin anëtar të origjinës.

2. Çdo kualifikim profesional që, ndonëse nuk plotëson kërkesat aktuale të parashikuara nga legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës për hyrjen ose ushtrimin e një profesioni, i jep mbajtësit të drejta të fituara në përputhje me atë legjislacion, trajtohet nga autoriteti kompetent si dëshmi e vlefshme kualifikimi sipas këtij kreu.

3. Në veçanti, në rastet kur një shtet anëtar ka rritur nivelin e kërkuar të formimit për ushtrimin e një profesioni dhe një profesionist, në përputhje me legjislacionin e mëparshëm të atij shteti, gëzon të drejta të fituara, autoriteti kompetent e konsideron formimin e përfunduar sipas rregullave të mëparshme si të barasvlershëm me nivelin e ri të formimit për qëllime të njohjes sipas këtij kreu.

Neni 21

Kushtet për njohjen e kualifikimeve profesionale

1. Autoriteti kompetent njeh të drejtën për ushtrimin e një profesioni të rregulluar për profesionistin që:

- a) zotëron një dëshmi kualifikimi formal ose një vërtetim të kompetencës profesionale të lëshuar nga një shtet anëtar, që kërkohet në atë shtet për të fituar të drejtën për të ushtruar profesionin përkatës;

b) dëshmia ose vërtetimi është lëshuar nga një autoritet kompetent i atij shteti, i përcaktuar sipas legjislacionit të tij, dhe përputhet me një nga nivelet e kualifikimit të përcaktuara në këtë kre.

2. E drejta për ushtrimin e profesionit njihet gjithashtu për profesionistin që ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme me kohë të plotë ose ekuivalentin me kohë të pjesshme për të paktën një vit gjatë dhjetë viteve të fundit një profesion që nuk është i rregulluar në shtetin anëtar të origjinës, dhe që zotëron një kualifikim profesional në një nga nivelet e përcaktuara sipas këtij kreu, për sa kohë që plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) zotëron një ose më shumë dëshmi kualifikimi formal ose vërtetime të aftësisë profesionale të lëshuara nga ai shtet;

b) dëshmitë ose vërtetimet janë lëshuar nga një autoritet kompetent sipas ligjit të atij shteti; dhe

c) ato vërtetojnë se mbajtësi është përgatitur për ushtrimin e profesionit përkatës.

3. Kërkesa për një vit përvojë profesionale sipas paragrafit 2 nuk zbatohet nëse dëshmia e kualifikimit formal vërteton se formimi dhe arsimi profesional përkatës është i rregulluar.

4. Autoriteti kompetent njeh nivelin e kualifikimit profesional të vërtetuar nga shteti anëtar i origjinës në përputhje me nenin 19 të këtij ligji. Në rastin e arsimit dhe formimit profesional të rregulluar ose të formimit profesional me strukturë të posaçme, autoriteti kompetent njeh barasvlerën me nivelin përkatës sipas paragrafit 3, nënparagrafi a) të nenit 19, nëse kjo përputhshmëri vërtetohet nga një certifikatë e posaçme e lëshuar nga shteti i origjinës.

5. Përfundimisht, autoriteti kompetent mund të refuzojë njohjen e një vërtetimi të aftësisë profesionale të klasifikuar në nivelin e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafin a) të nenit 19, kur për ushtrimin e profesionit përkatës në Republikën e Shqipërisë kërkohet një kualifikim profesional i klasifikuar në nivelin e përcaktuar në paragrafin 5 të po atij neni.

Neni 22

Masat e kompensimit

1. Autoriteti kompetent mund t'i kërkojë profesionistit të përmbushë një masë kompensimi, në formën e një periudhe përshtatjeje deri në tre vjet ose të kalojë një test të përshtatshmërisë, kur:

a) formimi i ndjekur nga profesionisti mbulon çështje thelbësisht të ndryshme nga ato që kërkohen për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë; ose

b) profesioni i rregulluar në Republikën e Shqipërisë përfshin një ose më shumë veprimtari profesionale të rregulluara që nuk ekzistojnë në profesionin e rregulluar në shtetin anëtar të origjinës dhe formimi i kërkuar për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë mbulon çështje thelbësisht të ndryshme nga ato që mbulohen nga dëshmia e aftësive ose dëshmia e kualifikimit formal të profesionistit.

2. Në rastet e parashikuara në paragrafin 1, autoriteti kompetent i garanton profesionistit të drejtën të zgjedhë ndërmjet periudhës së përshtatjes dhe testit të përshtatshmërisë *dhe e informon profesionistin në mënyrë të qartë për këtë të drejtë.*

3. Përjashtimisht nga paragrafi 2, autoriteti kompetent vendos vetë masën kompensuese në këto raste:

a) për ushtrimin e profesioneve ku kërkohet njohuri specifike e legjislacionit kombëtar dhe ofrimi i këshillimit ose ndihmës lidhur me të përbën pjesë thelbësore të aktivitetit profesional;

b) për rastet e përcaktuara në nënparagrafin c), ç), d), e) dhe ë) të nenit 18 të këtij ligji;

c) kur profesionisti, në kushtet e parashikuara në nënparagrafin b) të nenit 18 të këtij ligji, synon ushtrimin e aktivitetit si i vetëpunësuar ose si drejtues subjekti, ku kërkohet njohja dhe zbatimi i rregullave kombëtare specifike, me kusht që njohja dhe zbatimi i tyre të kërkohet edhe për shtetasit shqiptarë për ushtrimin e aktivitetit në fjalë;

ç) kur profesionisti zotëron një vërtetim të aftësisë profesionale të klasifikuar në nivelin a) të nenit 19 të këtij ligji, ndërsa për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë kërkohet një diplomë e klasifikuar në nivelin c) të nenit 19 të këtij ligji;

d) kur profesionisti zotëron një certifikatë të klasifikuar në nivelin b) të nenit 19 të këtij ligji, ndërsa për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë kërkohet një diplomë e klasifikuar në nivelin ç) ose d) të nenit 19 të këtij ligji;

dh) kur profesionisti zotëron një dëshmi të aftësisë profesionale të klasifikuar në nivelin a) të nenit 19 të këtij ligji, ndërsa për ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë kërkohet një diplomë e klasifikuar në nivelin ç) të nenit 19 të këtij ligji. Në këtë rast autoriteti kompetent mund të kërkojë njëkohësisht periudhë përshtatjeje dhe test të përshtatshmërisë.

Neni 23

Vlerësimi i çështjeve thelbësisht të ndryshme dhe procedurat për masat e kompensimit

1. Një formim ose kualifikim profesional konsiderohet se mbulon çështje thelbësisht të ndryshme nëse:

a) njohuritë, aftësitë ose kompetencat e fituara janë thelbësore për ushtrimin e profesionit përkatës në Republikën e Shqipërisë; dhe

b) formimi ose kualifikimi i profesionistit paraqet ndryshime në përmbajtje në lidhje me njohuritë, aftësitë ose kompetencat që janë thelbësore sipas kërkesave kombëtare për formim.

2. Autoriteti kompetent, përpara vendosjes së një mase kompensimi, vlerëson nëse përvoja profesionale ose formimi i vazhdueshëm i profesionistit, të njohura nga një organ kompetent i një shteti anëtar ose të një shteti të tretë, mbulojnë plotësisht ose pjesërisht çështjet e konsideruara thelbësisht të ndryshme.

3. Vendimi që vendos një masë kompensimi është i arsyetuar dhe përmban:

a) nivelin e kualifikimit profesional të kërkuar në Republikën e Shqipërisë dhe nivelin e kualifikimit profesional të zotëruar nga profesionisti sipas klasifikimit në nenin 19 të këtij ligji; dhe

- b) përshkrimin e çështjeve të konsideruara thelbësisht të ndryshme dhe arsyet pse ato nuk mund të kompensohen nga njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara gjatë përvojës profesionale ose të mësuarit gjatë gjithë jetës të profesionistit, të vlefësuar nga organi kompetent.
4. Testi i përshtatshmërisë organizohet brenda një periudhe prej jo më shumë se gjashtë muajsh nga data e vendimit që vendos detyrimin për kryerjen e tij.
 5. Profesionistit i garantohet e drejta për ta përsëritur, të paktën një herë, testin e përshtatshmërisë nëse dështon në të, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoriteti kompetent.
 6. Autoriteti kompetent organizon të paktën dy teste përshtatshmërie në vit, përveçse në rastet kur numri i aplikimeve nuk e justifikon këtë.

Neni 23/1

Kushtet shtesë për zbatimin e masave të kompensimit

1. Autoriteti kompetent i vë në dispozicion profesionistit informacion mbi mundësitë për përgatitjen për testin e përshtatshmërisë ose për periudhën e përshtatjes, përfshirë listat e materialeve të leximit të rekomanduara dhe materialet orientuese, kur këto janë të disponueshme.
2. Autoriteti kompetent siguron një listë të subjekteve ose personave të autorizuar për mbikëqyrjen e periudhës së përshtatjes dhe garanton, sa të jetë e mundur, të drejtën e profesionistit për të zgjedhur mbikëqyrësin dhe vendin ku do të kryhet periudha e përshtatjes.
3. Periudha e përshtatjes zhvillohet nën mbikëqyrjen e një profesionisti të kualifikuar dhe, në përfundim të saj, profesionisti i nënshtrohet një vlerësimi për të përcaktuar nëse janë përmbushur kushtet për njohjen e kualifikimit.
4. Pagesa gjatë periudhës së përshtatjes mund të përfitohet vetëm nëse parashikohet nga legjislacioni përkatës që rregullon periudhën e përshtatjes. Mungesa e pagesës nuk pengon kryerjen dhe vlerësimin e periudhës së përshtatjes.
5. Tarifat që mund të vendosen për organizimin e testit të përshtatshmërisë ose të periudhës së përshtatjes nuk duhet të tejkalojnë koston reale të procedurës dhe duhet të jenë të krahueshme me tarifat e aplikuara ndaj shtetasve shqiptarë në kushte të ngjashme.
6. Autoritetet kompetente janë përgjegjëse për përcaktimin e statusit që gëzon personi që i nënshtrohet periudhës së praktikës nën mbikëqyrje, në veçanti për sa i përket të drejtës së qëndrimit, si dhe detyrimeve, të drejtave dhe përfitimeve sociale, ndihmave dhe pagesave.

KREU III

SISTEMI I NJOHJES AUTOMATIKE MBI BAZËN E PËRVOJËS PROFESIONALE

Neni 24

Kërkesat për njohjen e përvojës profesionale

1. Kur në Republikën e Shqipërisë aksesit në ose ushtrimi i një veprimtarie profesionale është i kushtëzuar nga zotërimi i njohurive dhe aftësive të përgjithshme, tregtare ose profesionale,

autoriteti kompetent njeh si provë të mjaftueshme të këtyre njohurive dhe aftësive ushtrimin e mëparshëm të kësaj veprimtarie në një shtet anëtar tjetër, në përputhje me parashikimet e neneve 25, 26 dhe 27 të këtij Kreu.

2. Lista e veprimtarive profesionale që përfshihen në këtë sistem përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duke i ndarë ato në listat I, II dhe III, sipas grupimit dhe renditjes së bërë në Aneksin IV të Direktivës 2005/36/KE, për qëllime të zbatimit të neneve 25, 26 dhe 27 të këtij ligji.

Neni 25

Veprimtaritë e renditura në Listën I

1. Për njohjen bazuar në përvojën profesionale për veprimtaritë e renditura në Listën I, kërkohet që veprimtaria në fjalë të jetë ushtruar nga profesionisti në një nga format e mëposhtme:

- a) për gjashtë vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje; ose
- b) për tre vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën tre vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional; ose
- c) për katër vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën dy vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional; ose
- ç) për tre vite radhazi si i vetëpunësuar, nëse profesionisti vërteton se ka ushtruar veprimtarinë për të paktën pesë vite si i punësuar; ose
- d) për pesë vite radhazi në një pozicion ekzekutiv, nga të cilat të paktën tre vite përfshijnë detyra teknike dhe përgjegjësi për të paktën një departament të një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën tre vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional.

2. Në rastet e parashikuara në nënparagrafët a) dhe ç) të paragrafit 1 të këtij neni, ushtrimi i veprimtarisë nuk duhet të ketë përfunduar më herët se dhjetë vite nga data e paraqitjes së aplikimit të plotë nga profesionisti.

3. Nënparagrafi d) e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohet për aktivitetet e Grupit ex 855, "parukeri", sipas Nomenklaturës ISIC.

Neni 26

Veprimtaritë e renditura në Listën II

1. Për njohjen bazuar në përvojën profesionale për veprimtaritë e renditura në Listën II, kërkohet që veprimtaria në fjalë të jetë ushtruar nga profesionisti në një nga format e mëposhtme:

- a) për pesë vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje; ose
- b) për tre vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën tre vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional; ose
- c) për katër vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën dy vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional; ose
- ç) për tre vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ushtruar veprimtarinë si punëmarrës për të paktën pesë vite; ose
- d) për pesë vite radhazi si punëmarrës, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën tre vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional; ose
- dh) për gjashtë vite radhazi si punëmarrës, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë me kohëzgjatje të paktën dy vjet, të vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional.

2. Në rastet e parashikuara në nënparagrafët a) dhe ç) të paragrafit 1 të këtij neni, ushtrimi i veprimtarisë nuk duhet të ketë përfunduar më herët se dhjetë vite nga data e paraqitjes së aplikimit të plotë nga profesionisti.

Neni 27

Veprimtaritë e renditura në Listën III

1. Për njohjen bazuar në përvojën profesionale për veprimtaritë e renditura në Listën III, kërkohet që veprimtaria në fjalë të jetë ushtruar nga profesionisti në një nga format e mëposhtme:

- a) për tre vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje; ose
- b) për dy vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë, i vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional; ose
- c) për dy vite radhazi si i vetëpunësuar ose si drejtues i një sipërmarrjeje, nëse profesionisti vërteton se ka ushtruar veprimtarinë si punëmarrës për të paktën tre vite; ose

ç) për tre vite radhazi si punëmarrës, nëse profesionisti vërteton se ka ndjekur një formim paraprak për veprimtarinë në fjalë, i vërtetuar me një certifikatë të njohur nga shteti anëtar ose të vlerësuar si të vlefshme nga një organ kompetent profesional.

2. Në rastet e parashikuara në nënparagrafët a) dhe c) të paragrafit 1 të këtij neni, ushtrimi i veprimtarisë nuk duhet të ketë përfunduar më herët se dhjetë vite nga data e paraqitjes së aplikimit të plotë nga profesionisti.

KREU IV

SISTEMI I NJOHJES AUTOMATIKE TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE MBI BAZËN E KUSHTEVE MINIMALE TË FORMIMIT

Seksioni I

Dispozita të përgjithshme

Neni 28

Parimi i njohjes automatike

1. Autoritetet kompetente njohin, për efekt të aksesit dhe ushtrimit të aktiviteteve profesionale në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale dhe, sipas rastit, certifikatat shoqëruese të lëshuara nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar për profesionet e mëposhtme:

- mjek me formim bazë dhe mjek i specializuar;
- infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm;
- stomatolog me formim bazë dhe stomatolog i specializuar;
- mjek veteriner;
- farmacist;
- arkitekt;

nëse këto dëshmi dhe certifikata janë të listuara në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përmbushin kërkesat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar që përafron kushtet minimale të formimit përkatës për secilin profesion.

2. Dëshmitë e njohura kanë të njëjtin efekt juridik në territorin e Republikës së Shqipërisë si dëshmitë përkatëse të kualifikimeve formale të lëshuara nga autoritetet shqiptare.

3. Dëshmitë e kualifikimeve duhet të jenë të lëshuara nga organet kompetente të shteteve anëtare dhe, sipas rastit, të shoqërohen me certifikatat përkatëse.

4. Njohja automatike nuk cenon të drejtat e fituara të njohura në bazë të këtij ligji.

Neni 29

Njohja e mjekëve të përgjithshëm

Autoritetet kompetente njohin, për qëllim të ushtrimit të profesionit të mjekut të përgjithshëm brenda sistemit kombëtar të kujdesit shëndetësor, dëshmitë e kualifikimeve formale të listuara në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të cilat përmbushin kushtet përkatëse të formimit.

Neni 30

Njohja automatike e kualifikimeve të mamive

1. Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të mamive, të lëshuara nga një shtet anëtar, të listuara në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 34 të këtij ligji me kusht që:

a) kualifikimi të jetë përfituar në përputhje me një nga trajektoret e formimit të përcaktuara në legjislacionin shqiptar që transponon kushtet minimale të formimit të mamive dhe

b) të plotësohen njëkohësisht edhe kriteret shtesë të përcaktuara në këtë nen.

2. Njohja automatike jepet kur dëshmia e kualifikimit përputhet me një nga këto kritere shtesë:

a) formim me kohë të plotë për të paktën tre vite si mami, që përfshin jo më pak se 4600 orë formimi teorik dhe praktik, nga të cilat të paktën një e treta përfaqëson praktikë klinike;

b) formim me kohë të plotë si mami për të paktën dy vite dhe jo më pak se 3600 orë, me kusht që mbajtësi të zotërojë më parë një dëshmi kualifikimi si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, listuar sipas aktit nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji;

c) formim me kohë të plotë si mami për të paktën 18 muaj dhe jo më pak se 3000 orë, pas përfitimit të një dëshmie kualifikimi si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, listuar sipas aktit nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji të ndjekur nga një vit praktikë profesionale për të cilën është lëshuar një certifikatë sipas paragrafit 3 të këtij neni.

3. Në rastin e parashikuar në paragrafin 2, nenparagrafi “c”, dëshmia e kualifikimit duhet të shoqërohet me një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, e cila vërteton se mbajtësi, pas përfundimit të formimit si mami, ka ushtruar të gjitha aktivitetet përkatëse të këtij profesioni për një periudhë njëvjeçare, në një spital ose institucion të kujdesit shëndetësor të miratuar për këtë qëllim.

4. Dëshmitë e kualifikimit të njohura në përputhje me këtë nen gëzojnë të njëjtin efekt juridik në territorin e Republikës së Shqipërisë si dëshmitë e lëshuara nga autoritetet shqiptare për ushtrimin e profesionit të mamisë.

5. Kjo dispozitë nuk cenon të drejtat e fituara sipas këtij ligji.

Neni 31

Përjashtimi lidhur me hapjen e farmacive të reja

1. Autoritetet kompetente mund të refuzojnë njohjen e dëshmive të kualifikimeve formale të farmacistëve, të listuara në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për qëllim të hapjes së një farmacie të re të hapur për publikun, në rastet dhe kushtet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar. Për qëllimet e këtij paragrafi, farmaci të reja konsiderohen edhe ato që kanë qenë të hapura për më pak se tre vjet.

2. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 nuk zbatohet për farmacistët:

a) dëshmia e kualifikimeve e të cilëve është njohur më parë nga autoriteti kompetent shqiptar për një qëllim tjetër profesional, dhe

b) që kanë ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme profesionin e farmacistit për të paktën tre vite të njëpasnjëshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 31/1

Njohja e përvojës profesionale për ushtrimin e aktiviteteve të caktuara të farmacistit

1. Kur ushtrimi i një ose më shumë aktiviteteve profesionale të farmacistit, të përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi, kushtëzohet me përvojë profesionale shtesë përveç posedimit të një dëshmie të kualifikimit të njohur në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku është përfutur kualifikimi, e cila vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetin përkatës për një periudhë të krahasueshme.

2. Kjo dispozitë nuk cenon rregullimet e veçanta të parashikuara në legjislacionin kombëtar për farmacistë që përfshihen në skema specifike organizimi ose funksionimi, të cilat nuk gjejnë zbatim ndaj farmacistëve shtetas të vendeve anëtare që kërkojnë ushtrimin e profesionit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Kushtet për njohjen e kualifikimeve të arkitektëve

1. Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të arkitektit në Republikën e Shqipërisë, vetëm ato dëshmi të kualifikimeve formale për të cilat

formimi profesional ka filluar jo më herët se viti akademik i përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1 e këtij neni, autoritetet kompetente njohin si të barasvlershme me dëshmitë e përmendura edhe ato dëshmi të kualifikimit që janë përfituar nëpërmjet rrugëve alternative të formimit profesional, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) formimi është realizuar si pjesë e skemave sociale të përmirësimit ose nëpërmjet studimeve me kohë të pjesshme në nivel universiteti;

b) mbajtësi ka ushtruar për një periudhë jo më të shkurtër se shtatë vite aktivitet profesional në fushën e arkitekturës, nën mbikëqyrjen e një arkitekti ose subjekti të licencuar për ofrimin e shërbimeve të projektimit arkitektonik;

c) mbajtësi ka përfunduar me sukses një provim në arkitekturë në nivel universiteti, të barasvlershëm me provimin përfundimtar të parashikuar në trajektoren standarde të formimit, dhe të vërtetuar nga autoriteti kompetent i shtetit ku është zhvilluar veprimtaria profesionale.

Neni 33

Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat

1. Aksesi dhe ushtrimi i aktiviteteve profesionale të përcaktuara në këtë Titull kushtëzohen nga posedimi i një dëshmie të kualifikimeve formale të listuara në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, që vërteton përmbushjen e njohurive, aftësive dhe kompetencave të kërkuara sipas legjislacionit shqiptar.

2. Autoritetet kompetente nuk kontrollojnë përmbajtjen e formimit të kryer në një shtet anëtar të BE-së për kualifikimet e listuara në aktin nënligjor të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Përditësimi i standardeve të njohurive, aftësive dhe kompetencave reflektohet përmes përditësimit të akteve nënligjore përkatëse, në përputhje me zhvillimet në sistemet e arsimit dhe formimit profesional të njohura nga legjislacioni shqiptar.

Neni 34

Miratimi dhe përditësimi i listës së dëshmive të kualifikimeve formale dhe dokumenteve shoqëruese

1. Lista e dëshmive të kualifikimeve formale dhe, sipas rastit, e certifikatave shoqëruese për profesionet e parashikuara në këtë kre, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e njohjes së kualifikimeve profesionale të fituara në Bashkimin Evropian.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave përditësohet sa herë që BE-ja miraton ndryshime në listat e dëshmive të kualifikimeve profesionale.

3. Procedurat për miratimin dhe përditësimin e listës rregullohen me akt nënligjor, duke garantuar transparencë dhe konsultim me autoritetet kompetente dhe grupet e interesit.

Seksioni II

Të drejtat e fituara për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale

Neni 35

Njohja e kualifikimeve të fituara përpara datave të referencës

Pa cënuar të drejtat e fituara specifike për profesionet përkatëse, autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme për hyrjen dhe ushtrimin e aktiviteteve profesionale në Republikën e Shqipërisë dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të shteteve anëtare për profesionet e:

- mjek me formim bazë dhe mjek i specializuar;
- infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm;
- stomatolog me formim bazë dhe stomatolog i specializuar;
- mjek veteriner;
- mami;
- farmacist,

nëse:

a) formimi nuk përmbush të gjitha kërkesat e formimit, ka filluar përpara datave të referencës të përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji, dhe

b) dëshmia shoqërohet me një certifikatë të autoritetit kompetent të shtetit anëtar që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme profesionin përkatës për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës.

Neni 36

Njohja e kualifikimeve të lëshuara nga ish-Republika Demokratike Gjermane

Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme dëshmitë e kualifikimeve formale të lëshuara në territorin e ish-Republikës Demokratike Gjermane për profesionet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji, kur:

a) formimi nuk përmbush të gjitha kërkesat e formimit dhe ka filluar:

- përpara 3 tetorit 1990 për mjekët me formim bazë, infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, stomatologët me formim bazë, stomatologët e specializuar, mjekët veterinerë, mamitë dhe farmacistët, ose
- përpara 3 prillit 1992 për mjekët specialistë,

dhe

b) dëshmia shoqërohet me certifikatën që vërteton ushtrimin efektiv dhe të ligjshëm të profesionit për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve para datës së lëshimit të certifikatës në territorin e Gjermanisë.

Neni 37

Njohja e kualifikimeve të lëshuara nga ish-Çekosllovakia

Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të shteteve anëtare, të lëshuara nga ish-Çekosllovakia ose nga Republika Çeke dhe Republika Sllovake për formime të filluara përpara datës 1 janar 1993, për profesionet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe për profesionin e arkitektit, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) autoriteti kompetent i Republikës Çeke ose i Republikës Sllovake vërteton se dëshmia ka të njëjtën vlefshmëri juridike si dëshmitë e përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji; dhe

b) dëshmia shoqërohet me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent përkatës që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet profesionale për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës brenda territorit të tyre.

Neni 38

Njohja e kualifikimeve të lëshuara nga ish-Bashkimi Sovjetik

1. Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të shteteve anëtare, të lëshuara nga ish-Bashkimi Sovjetik ose për formime të filluara përpara datave:

- 20 gusht 1991 për Estoninë;
- 21 gusht 1991 për Letoninë;
- 11 mars 1990 për Lituaninë;

për profesionet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe për profesionin e arkitektit, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) autoriteti kompetent i Estonisë, Letonisë ose Lituanisë vërteton se dëshmia ka të njëjtën vlefshmëri juridike si dëshmitë e përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji; dhe

b) dëshmia shoqërohet me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent përkatës që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet profesionale për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës brenda territorit të tyre.

2. Për dëshmitë e kualifikimeve të mjekëve veterinerë të lëshuara nga ish-Bashkimi Sovjetik për Estoninë, kërkohet që certifikata të vërtetojë ushtrimin efektiv dhe të ligjshëm të aktivitetit për të paktën pesë vite gjatë shtatë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës brenda territorit të tyre.

Neni 39

Njohja e kualifikimeve të lëshuara nga ish-Jugosllavia

1. Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të shteteve anëtare, të lëshuara nga ish-Jugosllavia ose për formime të filluara përpara datave:

- 25 qershor 1991 për Slloveninë;
- 8 tetor 1991 për Kroacinë;

për profesionet e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe për profesionin e arkitektit, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) autoriteti kompetent i Sllovenisë ose i Kroacisë vërteton se dëshmia ka të njëjtën vlefshmëri juridike si dëshmitë e përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji; dhe

b) dëshmia shoqërohet me një certifikatë të lëshuar nga i njëjti autoritet kompetent që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet profesionale për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës brenda territorit të tyre.

Neni 40

Njohja e dëshmive të kualifikimeve që nuk përputhen me titujt standardë

1. Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme për hyrjen dhe ushtrimin e aktiviteteve profesionale në Republikën e Shqipërisë dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të shteteve anëtare, për profesionet e:

- mjek me formim bazë;
- infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm;
- stomatolog me formim bazë;
- mjek veteriner;
- mami;
- farmacist,

edhe kur titujt e dëshmive nuk përputhen me titujt e përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) dëshmia shoqërohet me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar që vërteton se formimi është përfunduar me sukses në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në legjislacionin kombëtar që transponon standardet e Bashkimit Evropian; dhe

b) dëshmia trajtohet nga shteti anëtar që e ka lëshuar atë në mënyrë të barabartë me titujt e përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji.

Neni 41

Mospërfitimi i të drejtave për njohje për titullin "feldsher"

Mbajtësit e titullit "фелдшер" (feldsher), të lëshuar në Bullgari përpara datës 31 dhjetor 1999, nuk gëzojnë të drejtën e njohjes profesionale në Republikën e Shqipërisë si mjek me formim bazë ose si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm në kuptim të këtij ligji.

Seksioni III

Të drejtat e fituara për njohjen e kualifikimeve të mjekëve specialistë

Neni 42

Njohja e formimit me kohë të pjesshme të mjekëve specialistë

Autoritetet kompetente mund të kërkojnë që dëshmitë e kualifikimeve formale të mjekëve specialistë, të cilët kanë ndjekur formimin e specializuar me kohë të pjesshme në përputhje me dispozitat ligjore, nënligjore dhe administrative në fuqi më 20 qershor 1975 dhe që kanë filluar formimin e specializimit jo më vonë se 31 dhjetor 1983, të shoqërohen me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetin përkatës për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës.

Neni 43

Njohja e kualifikimeve të mjekëve specialistë të lësuara në Spanjë

1. Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme për hyrjen dhe ushtrimin e aktiviteteve profesionale në Republikën e Shqipërisë kualifikimet e mjekëve specialistë të lësuara në Spanjë për mjekët që kanë përfunduar formimin e specializimit përpara datës 1 janar 1995, edhe nëse ky formim nuk përmbush kushtet minimale të formimit, nëse plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) kualifikimi është shoqëruar me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i Spanjës që vërteton se mbajtësi ka kaluar me sukses provimin e kompetencës profesionale të zhvilluar në kuadër të masave të posaçme të njohjes, të përcaktuara në Dekretin Mbretëror 1497/1999 të Spanjës; dhe

b) certifikata vërteton se mbajtësi zotëron një nivel njohurish dhe aftësish të krahasueshëm me atë të mjekëve specialistë, për të cilët kualifikimet janë përcaktuar në:

aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji për formalizimin e titujve të specializimeve.

Neni 44

Njohja e kualifikimeve të mjekëve specialistë të lëshuara në Itali

Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme për hyrjen dhe ushtrimin e aktiviteteve profesionale në Republikën e Shqipërisë dëshmitë e kualifikimeve formale të lëshuara në Itali për mjekë që kanë filluar formimin e specializuar pas datës 31 dhjetor 1983 dhe përpara datës 1 janar 1991, për profesionin e mjekut specialist të listuar në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji, nëse këto dëshmi shoqërohen me një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente italiane që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet profesionale në Itali si mjek specialist në të njëjtin drejtim specializimi, për të paktën shtatë vite të njëpasnjëshme gjatë dhjetë viteve përpara datës së lëshimit të certifikatës.

Neni 45

Të drejtat e fituara në rast të shfuqizimit të rregullimeve për formimin e mjekëve specialistë

Nëse Republika e Shqipërisë shfuqizon dispozitat ligjore, nënligjore ose administrative që rregullojnë dhënien e dëshmimeve të kualifikimeve formale si mjek specialist, të përcaktuara në aktet nënligjore të miratuara në bazë të nenit 34 të këtij ligji, dhe miraton masa që sigurojnë të drejtat e fituara për shtetasit shqiptarë, këto masa zbatohen në mënyrë të barabartë për shtetasit e shteteve anëtare, nëse dëshmia e kualifikimit është lëshuar përpara datës së shfuqizimit përkatës për specializimin përkatës.

Neni 46

Njohja e të drejtave të fituara për ushtrimin e profesionit të mjekut të përgjithshëm

1. Autoritetet kompetente njohin, për qëllim të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mjekut të përgjithshëm në kuadër të sistemit të sigurimeve shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, certifikatën e lëshuar nga një shtet anëtar, për çdo shtetas të një shteti anëtar që:

a) më datën e referencës të përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji ka pasur të drejtë të ushtrojë profesionin e mjekut të përgjithshëm në kuadër të sistemit kombëtar të sigurimeve shëndetësore të atij shteti anëtar; dhe

b) e ka përfituar këtë të drejtë mbi bazën e kualifikimeve që japin akses në ushtrimin e profesionit të mjekut me formim bazë, të njohura sipas këtij ligji në përputhje me nenin 28, ose nenin 35 .

2. Certifikata e përmendur në paragrafin 1, e lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, njihet nga autoritetet kompetente shqiptare dhe ka të njëjtin efekt juridik si dëshmia e kualifikimeve formale e përcaktuar në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit

34 të këtij ligji, për qëllim të ushtrimit të profesionit të mjekut të përgjithshëm në kuadër të sistemit të sigurimeve shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Seksioni IV

Të drejtat e fituara për profesionin e infermierit përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm

Neni 47

Kushti shtesë për ushtrimin e të drejtave të fituara nga infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm

Në rastet kur infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm përfitojnë të drejtën e njohjes në bazë të nenit 35 të këtij ligji, aktivitetet e ushtruara gjatë përvojës profesionale që shoqëron dëshminë e kualifikimit duhet të përfshijnë përgjegjësi të plotë për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e kujdesit infermior ndaj pacientit.

Neni 48

Njohja e kualifikimeve të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm të lëshuara në Poloni

Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme për hyrjen dhe ushtrimin e profesionit të infermierit përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve të lëshuara në Poloni, për personat që:

a) kanë përfunduar formimin përpara datës 1 maj 2004, edhe nëse ky formim nuk përmbushte kushtet minimale të formimit për këtë profesion; dhe

b) mbajnë diplomën “*bachelor*” të përfituar në bazë të një programi të posaçëm të përmirësimit të kualifikimit profesional, të zhvilluar në përputhje me një nga këto instrumente ligjore polake:

i. Neni 11 i Ligjit të datës 20 prill 2004 për ndryshimin e Ligjit për profesionet e infermierit dhe mamisë dhe të disa akteve të tjera (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë e vitit 2004, Nr. 92, pos. 885, dhe e vitit 2007, Nr.176, pos.1237), dhe Rregullorja e Ministrit të Shëndetësisë e datës 11 maj 2004 për kushtet e hollësishme për realizimin e studimeve për infermierë dhe mami, për personat që zotërojnë certifikatë të arsimit të mesëm dhe janë diplomuar nga lice dhe shkolla profesionale mjekësore në profesionin e infermierit ose mamisë (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë e vitit 2004, Nr. 110, pos. 1170, dhe e vitit 2010, Nr.65, pos 420) ; ose

ii. Neni 52.3 pika 2 e Ligjit të datës 15 korrik 2011 për profesionet e infermierit dhe mamisë (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë e vitit 2011, Nr. 174, pos. 1039), dhe Rregullorja e Ministrit të Shëndetësisë e datës 14 qershor 2012 për kushtet e hollësishme për zhvillimin e kurseve të arsimit të lartë për infermierë dhe mami që përfundojnë shkolla të mesme mjekësore ose pas të mesme për profesionin e infermierit ose mamisë (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë e vitit 2012, pos. 770) .

Dëshmitë e kualifikimit të përmendura në këtë nen njihen si të barasvlershme me ato të listuara për Poloninë në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

Neni 49

Njohja e kualifikimeve të infermierëve përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm të lëshuara në Rumani

1. Autoritetet kompetente njohin si provë të mjaftueshme për hyrjen dhe ushtrimin e profesionit të infermierit përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, vetëm dëshmitë e kualifikimeve të lëshuara në Rumani, për personat që:

a) kanë përfunduar formimin i cili nuk përmbush kushtet minimale të formimit; dhe

b) mbajnë një nga dëshmitë e mëposhtme të kualifikimit, të shoqëruar me një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente rumune që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet e një infermieri përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm në Rumani, duke marrë përgjegjësi të plotë për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e kujdesit infermior ndaj pacientëve, për një periudhë të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve para datës së lëshimit të certifikatës:

i. *“Certificat de competențe profesionale de asistent medical generalist”*, i përfutur në përfundim të arsimit pas të mesëm *“școală postliceală”*, që dëshmon fillimin e formimit përpara datës 1 janar 2007;

ii. *“Diplomă de absolvire de asistent medical generalist”*, për arsimin e lartë afatshkurtër, që dëshmon fillimin e formimit përpara datës 1 tetor 2003;

iii. *“Diplomă de licență de asistent medical generalist”*, për arsimin e lartë afatgjatë, që dëshmon fillimin e formimit përpara datës 1 tetor 2003.

c) mbajnë një nga dëshmitë e përmendura në nënparagrafin b, nënparagrafin ii ose iii, të shoqëruar me diplomën *“Diplomă de licență”* të përfutur në bazë të programit të posaçëm për përmirësimin e formimit fillestar, të zhvilluar në përputhje me:

i. Neni 3(2) i Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit Kombëtar dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 4317/943/2014, datë 11.08.2014, për miratimin e programit të posaçëm të përmirësimit të formimit fillestar për infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm të diplomuar përpara 1 janarit 2007 (botuar në Fletoren Zyrtare të Rumanisë nr. 624, datë 26.08.2014); dhe

ii. Suplementi i diplomës që vërteton përfundimin me sukses të këtij programi.

ç) mbajnë dëshminë e përmendur në nënparagrafin b, nënparagrafin i, të shoqëruar me certifikatën *“Certificat de revalorizare a competențelor profesionale”*, të përfutur në përputhje me:

i. Nenin 3(1) dhe Aneksin 3 të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit Kombëtar dhe Ministrit të Shëndetësisë nr. 4317/943/2014, datë 11.08.2014; dhe

ii. Nenin 16 të Urdhrit të Ministrit të Arsimit Kombëtar nr. 5114/2014, për miratimin e metodologjisë për organizimin, zhvillimin dhe përfundimin e programit të posaçëm të përmirësimit për infermierët përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm të diplomuar përpara datës 1 janar 2007 (botuar në Fletoren Zyrtare të Rumanisë nr. 5, datë 06.01.2015).

2. Dëshmitë e kualifikimit të përmendura në këtë nen njihen si të barasvlershme me ato të listuara për Rumaninë në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

Neni 50

Vlefshmëria e njohjeve të mëparshme për kualifikimet e infermierëve të trajnuar në Rumani

Autoritetet kompetente njohin si të vlefshme për hyrjen dhe ushtrimin e profesionit të infermierit përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë çdo vendim njohjeje të marrë përpara datës 3 mars 2024 nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian në bazë të sistemit të përgjithshëm të njohjes së kualifikimeve, nëse vendimi ka të bëjë me shtetas të një shteti anëtar të cilët janë formuar në Rumani si infermierë përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm dhe nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji.

Seksioni V

Të drejtat e fituara për njohjen e kualifikimeve të stomatologëve

Neni 51

Njohja e të drejtave të fituara për stomatologët me formim bazë

1. Autoritetet kompetente njohin, për qëllim të ushtrimit të profesionit të stomatologut me formim bazë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, të lëshuara në Itali, Spanjë, Austri, Republikën Çeke, Sllovaki dhe Rumani, për shtetas të një shteti anëtar që kanë filluar formimin mjekësor përpara datës së referencës të përcaktuar përkatësisht në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji, me kusht që këto dëshmi të jenë të shoqëruara me një certifikatë të autoritetit kompetent të shtetit anëtar përkatës, që vërteton njëkohësisht se:

a) mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive, të ligjshme dhe kryesore në atë shtet anëtar aktivitetet profesionale të cilat përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve që prekin dhëmbët, zgavrën e gojës, nofullat dhe indet përreth tyre, duke respektuar dispozitat rregullatore dhe rregullat e etikës profesionale, për një periudhë jo më të shkurtër se tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës; dhe

b) mbajtësi është i autorizuar të ushtrojë këto aktivitete në të njëjtat kushte si mbajtësit e dëshmive të kualifikimit të listuara për atë shtet anëtar në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji.

2. Personat që kanë përfunduar me sukses të paktën tre vite studimi, të certifikuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar përkatës si të barasvlershme me formimin bazë për stomatologët, sipas standardeve minimale për këtë profesion, përjashtohen nga kërkesa për përvojën praktike të përmendur në paragrafin 1, nenparagrafi “a”.

3. Për qëllimet e këtij neni, dëshmitë e kualifikimit të lëshuara në ish-Çekosllovakë për formime të filluara përpara datës 1 janar 1993 njihen si të barasvlershme me dëshmitë e lëshuara nga Republika Çeke dhe Republika Sllovake, dhe në të njëjtat kushte siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 52

Njohja e të drejtave të fituara për stomatologët me formim bazë të kualifikuar në Itali

1. Autoritetet kompetente njohin, për qëllim të ushtrimit të profesionit të stomatologut me formim bazë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, të lëshuara në Itali për shtetas të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian që kanë filluar formimin universitar në mjekësi pas datës 28 janar 1980 dhe jo më vonë se 31 dhjetor 1984, me kusht që dëshmitë të jenë të shoqëruara me një certifikatë të autoritetit kompetent italian që vërteton njëkohësisht se:

a) mbajtësi ka kaluar me sukses provimin e përshtatshmërisë të zhvilluar nga autoritetet kompetente italiane, i cili konstaton se ai zotëron një nivel njohurish dhe aftësish të krahasueshme me atë të mbajtësve të dëshmive të kualifikimit të listuara për Italinë në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji;

b) mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive, të ligjshme dhe kryesore në Itali aktivitetet profesionale të cilat përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve që prekin dhëmbët, zgavrën e gojës, nofullat dhe indet përreth tyre, duke respektuar dispozitat rregullatore dhe rregullat e etikës profesionale, për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës; dhe

c) mbajtësi është i autorizuar të ushtrojë aktivitetet e përcaktuara në nenparagrafin “b” në të njëjtat kushte si mbajtësit e dëshmive të kualifikimit të përfshira për Italinë në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

2. Personat që kanë përfunduar me sukses të paktën tre vite studimi, të certifikuar nga autoritetet kompetente italiane si të barasvlershme me formimin bazë për stomatologët, sipas standardeve minimale, përjashtohen nga kërkesa për përfundimin me sukses të provimit të përshtatshmërisë të përmendur në paragrafin 1, nenparagrafi “a”.

3. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për personat që kanë filluar formimin universitar në mjekësi pas datës 31 dhjetor 1984, për sa kohë që tre vitet e studimit të përmendura në paragrafin 2 kanë filluar përpara datës 31 dhjetor 1994.

Neni 53

Njohja sipas parimit të njohjes automatike për formime të filluara deri më 18 janar 2016

Autoritetet kompetente njohin, në përputhje me parimin e njohjes automatike të përcaktuar në nenin 28 të këtij ligji, dëshmitë e kualifikimeve formale si stomatolog për shtetas të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian që kanë filluar formimin profesional deri më datë 18 janar 2016.

Neni 54

Njohja e të drejtave të fituara për stomatologët me formim bazë në Spanjë

Autoritetet kompetente njohin, për qëllim të ushtrimit të profesionit të stomatologut me formim bazë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale si mjek, të lëshuara në Spanjë për profesionistë që kanë filluar formimin universitar në mjekësi ndërmjet datës 1 janar 1986 dhe 31 dhjetor 1997, me kusht që ato të jenë të shoqëruara me një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente spanjolle, e cila vërteton njëkohësisht se:

a) mbajtësi ka përfunduar me sukses të paktën tre vite studimi, të certifikuara nga autoritetet kompetente spanjolle si të barasvlershme me formimin bazë për stomatologët, në përputhje me kërkesat minimale për këtë profesion;

b) mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive, të ligjshme dhe kryesore në Spanjë aktivitetet profesionale të cilat përfshijnë parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e anomalive dhe sëmundjeve që prekin dhëmbët, zgavrën e gojës, nofullat dhe indet përreth tyre, duke respektuar dispozitat rregullatore dhe rregullat e etikës profesionale, për një periudhë jo më të shkurtër se tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës;

c) mbajtësi është i autorizuar të ushtrojë aktivitetet profesionale të përmendura në nënparagrafin “b”, në të njëjtat kushte si mbajtësit e dëshmimeve të kualifikimit të listuara për Spanjën në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji.

Seksioni VI

Të drejtat e fituara për njohjen e kualifikimeve të mjekëve veterinerë të formuar në Estoni

Neni 55

Njohja e të drejtave të fituara për mjekët veterinerë në Estoni

Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mjekut veteriner në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të një shteti anëtar, të lëshuara në Estoni ose që lidhen me formime të nisura në këtë shtet përpara datës 1 maj 2004, me kusht që dëshmia të jetë e shoqëruar me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent estonez, e cila vërteton se mbajtësi i saj ka ushtruar në mënyrë efektive, të ligjshme dhe të

pandërprerë aktivitetet profesionale si mjek veteriner në Estoni për të paktën pesë vite të njëpasnjëshme gjatë shtatë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës.

Seksioni VII

Të drejtat e fituara për njohjen e kualifikimeve të mamive

Neni 56

Njohja e të drejtave të fituara për mamitë me formim përpara datës së referencës

Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të një shteti anëtar, të cilat:

a) janë lëshuar përpara datës së referencës së përcaktuar përkatësisht në aktin nënligjor të miratuar në bazë të nenit 34 të këtij ligji; dhe

b) përputhen me kërkesat minimale të formimit për profesionin e mamisë, por që nuk përmbushin kriteret procedurale për njohje automatike të parashikuara në nenin 32 të këtij ligji; dhe

c) janë të shoqëruara me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar përkatës, që vërteton se mbajtësi i saj ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet profesionale të mamisë për një periudhë jo më të shkurtër se dy vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës.

Neni 57

Njohja automatike për mamitë me formim të nisur përpara datës 18 janar 2016

Autoritetet kompetente njohin automatikisht, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të lëshuara për shtetas të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, nëse formimi profesional si mami ka filluar përpara datës 18 janar 2016 dhe plotësohet një nga trajektorët e mëposhtme:

a) Trajektorja I: formimi ka qenë me kohë të plotë për të paktën tre vite dhe hyrja në këtë formim është bërë pas përfundimit të të paktën dhjetë viteve arsimit të përgjithshëm ose të një niveli të barasvlershëm me të; ose

b) Trajektorja II: formimi ka qenë me kohë të plotë për të paktën tetëmbëdhjetë muaj dhe hyrja në këtë formim është kushtëzuar nga zotërimi i një dëshmie të kualifikimit formal si infermier përgjegjës për kujdesin e përgjithshëm, i përfshirë në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

Dëshmitë e njohura në përputhje me këtë nen kanë të njëjtin efekt juridik në Republikën e Shqipërisë si dëshmitë e kualifikimeve të lëshuara nga autoritetet shqiptare për ushtrimin e profesionit të mamisë.

Neni 58

Njohja e të drejtave të fituara për mamitë e formuara në ish-Republikën Demokratike Gjermane

Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të një shteti anëtar, të cilat:

a) vërtetojnë përfundimin e formimit profesional në territorin e ish-Republikës Demokratike Gjermane, për një kurs formimi të nisur përpara datës 3 tetor 1990; dhe

b) përputhen me kërkesat minimale të formimit për profesionin e mamisë, por që nuk përmbushin kriteret procedurale për njohje automatike të parashikuara në nenin 32 të këtij ligji; dhe

c) janë të shoqëruara me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar përkatës, që vërteton se mbajtësi i saj ka ushtruar në mënyrë efektive dhe të ligjshme aktivitetet profesionale të mamisë për një periudhë prej jo më pak se dy vite radhazi gjatë pesë viteve që paraprijnë datën e lëshimit të certifikatës.

Neni 59

Njohja e kualifikimeve të mamive të formuara në Poloni përpara datës 1 maj 2004

Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të një shteti anëtar, të lëshuara në Poloni përpara datës 1 maj 2004, për sa kohë që plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) kualifikimi nuk përmbush kërkesat minimale të përcaktuara për formimin e mamive; dhe

b) kualifikimi dëshmohet nga një diplomë “bachelor” e përfituar në bazë të një programi të posaçëm të përmirësimit të kualifikimit profesional, të zhvilluar në përputhje me një nga këto dispozita të legjislacionit të Republikës së Polonisë:

i. Neni 11 i Ligjit të datës 20 prill 2004 për ndryshimin e Ligjit mbi profesionet e infermierit dhe mamisë dhe disa akteve të tjera (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë 2004 Nr. 92, pos. 885; dhe 2007 Nr. 176, pos. 1237), dhe Rregullorja e Ministrit të Shëndetësisë e datës 11 maj 2004 për kushtet e hollësishme të realizimit të studimeve për infermierë dhe mami për personat që zotërojnë certifikatë të arsimit të mesëm (maturë) dhe janë diplomuar në profesionin e infermierit ose mamisë në lice mjekësor ose në shkolla të mesme profesionale mjekësore (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë 2004 Nr. 110, pos. 1170 dhe 2010 Nr. 65, pos. 420); ose

ii. Neni 53.3 paragrafi 3 e Ligjit të datës 15 korrik 2011 mbi profesionet e infermierit dhe mamisë (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë 2011 Nr. 174, pos. 1039), dhe Rregullorja e Ministrit të Shëndetësisë e datës 14 qershor 2012 për kushtet e hollësishme për zhvillimin e studimeve të arsimit të lartë për infermierë dhe mami që zotërojnë certifikatë të arsimit të mesëm

(maturë) dhe janë diplomuar në një shkollë të mesme ose pas të mesme mjekësore në profesionin e infermierit ose mamisë (Fletore Zyrtare e Republikës së Polonisë 2012, pos. 770).

Diploma “*bachelor*” e fituar në përputhje me një nga rastet e përmendura më sipër pranohet si dëshmi e mjaftueshme që mbajtësi i saj zotëron një nivel njohurish dhe kompetencash të krahasueshme me atë të mamive që zotërojnë një nga dëshmitë e kualifikimeve të listuara për Poloninë në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

Neni 60

Njohja e të drejtave të fituara për mamitë e kualifikuara në Rumani përpara datës së anëtarësimit të këtij shteti në BE

Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë, vetëm dëshmitë e kualifikimeve formale të shtetasve të një shteti anëtar, të cilat:

a) janë lëshuar në Rumani përpara datës së anëtarësimit të këtij shteti në Bashkimin Evropian si “*asistent medical obstetrică-ginecologie*” dhënk përmbushin kërkesat minimale të formimit; dhe

c) janë të shoqëruara me një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent rumun, që vërteton se mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive, të ligjshme dhe të pandërprerë aktivitetet profesionale të mamisë në territorin e Rumanisë për një periudhë jo më të shkurtër se pesë vite të njëpasnjëshme gjatë shtatë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës.

Neni 61

Përfshirja nga njohja e të drejtave të fituara për disa kualifikime në fushën e mamisë të lëshuara në Kroaci

Kualifikimet e mëposhtme, të përfituara në Kroaci përpara datës 1 korrik 2013, nuk përfitojnë nga njohja mbi bazën e të drejtave të fituara, për qëllim të aksesit dhe ushtrimit të profesionit të mamisë në Republikën e Shqipërisë:

- a) “*viša medicinska sestra ginekološko-opstetričkog smjera*” (infermier i lartë me specializim në gjinekologji dhe obstetrikë);
- b) “*medicinska sestra ginekološko-opstetričkog smjera*” (infermier me specializim në gjinekologji dhe obstetrikë);
- c) “*viša medicinska sestra primaljskog smjera*” (infermier i lartë me diplomë në mami);
- ç) “*medicinska sestra primaljskog smjera*” (infermier me diplomë në mami);
- d) “*ginekološko-opstetrička primalja*” (mami në gjinekologji dhe obstetrikë);
- dh) “*primalja*” (mami).

Seksioni VIII

Të drejtat e fituara për profesionin e arkitektit

Neni 62

Njohja e të drejtave të fituara për arkitektët me formim të nisur përpara datës së referencës

1. Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të arkitektit në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve formale të lëshuara nga një shtet anëtar, të cilat:

a) janë të listuara në aktin nënligjor të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 34 të këtij ligji

b) vërtetojnë ndjekjen dhe përfundimin me sukses të një programi të formimit profesional që ka filluar jo më vonë se viti akademik i përcaktuar në të njëjtin akt nënligjor për shtetin përkatës.

2. Në rastin e dëshmimeve të kualifikimit të lëshuara pas datës 8 maj 1945 nga autoritetet kompetente të ish-Republikës Demokratike Gjermane, njohja jepet vetëm nëse këto dëshmi shoqërohen me një certifikatë të lëshuar nga autoritetet kompetente të Republikës Federale të Gjermanisë që vërteton barasvlerën me titujt e përfshirë në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të nenit 34 të këtij ligji

3. Autoritetet kompetente njohin gjithashtu, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të arkitektit në Republikën e Shqipërisë, çdo dëshmi të kualifikimit të përfshirë në aktin nënligjor të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nëse programi përkatës i formimit ka filluar përpara datës 18 janar 2016.

Neni 63

Njohja e të drejtës për përdorimin e titullit “arkitekt” në bazë të rregullimeve kombëtare të shteteve anëtare

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 62 të këtij ligji, autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të arkitektit në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve të lëshuara nga shtetet anëtare, për shtetasit e tyre, nëse ato shoqërohen me një certifikatë që vërteton njëkohësisht se:

a) mbajtësi ka qenë i autorizuar, jo më vonë se në njërën prej datave të përcaktuara më poshtë, të përdorë titullin profesional “arkitekt” në përputhje me rregullat kombëtare të shtetit përkatës; dhe

b) mbajtësi ka ushtruar në mënyrë efektive veprimtaritë përkatëse profesionale të një arkitekti për të paktën tre vite të njëpasnjëshme gjatë pesë viteve që i paraprijnë datës së lëshimit të certifikatës.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen për shtetet anëtare të mëposhtme, duke respektuar datat përkatëse kur rregullat kombëtare që rregullojnë përdorimin e titullit “arkitekt” kanë qenë në fuqi:

- a) më 1 janar 1995 për Austrinë, Finlandën dhe Suedinë;
- b) më 1 maj 2004 për Çekinë, Estoninë, Qipron, Letoninë, Lituaninë, Hungarinë, Maltën, Poloninë, Slloveninë dhe Sllovakinë;
- c) më 1 korrik 2013 për Kroacinë;
- ç) më 5 gusht 1987 për të gjitha shtetet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 64

Njohja e kualifikimeve të arkitektëve të diplomuar në “*Fachhochschulen*” në Gjermani

Autoritetet kompetente njohin, për qëllime të hyrjes dhe ushtrimit të profesionit të arkitektit në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e përfundimit të një formimi profesional:

- a) të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë të tipit “*Fachhochschule*” në Republikën Federale të Gjermanisë, për një periudhë prej tre vitesh;
- b) të cilat kanë ekzistuar më datë 5 gusht 1985 dhe janë ndjekur jo më vonë se data 17 janar 2014;
- c) që përmbushin kërkesat për njohuri, aftësi dhe kompetenca të përcaktuara në legjislacionin shqiptar që përafron standardet minimale të formimit profesional për arkitektët;
- ç) dhe japin të drejtë për të ushtruar aktivitetet profesionale përkatëse në territorin e Republikës Federale të Gjermanisë nën titullin profesional “arkitekt”.

Këto dëshmi njihen vetëm nëse formimi i përmendur më sipër është ndjekur nga një periudhë prej katër vitesh përvojë profesionale efektive dhe të ligjshme në Republikën Federale të Gjermanisë, e vërtetuar përmes një certifikate të lëshuar nga autoriteti kompetent gjerman, në regjistrin e të cilit është i regjistruar emri i arkitektit që kërkon njohjen.

KREU V

SISTEMI I NJOHJES AUTOMATIKE MBI BAZËN E KUADRIT TË PËRBASHKËT TË FORMIMIT

Neni 65

Njohja automatike mbi bazën e kuadrin të përbashkët të formimit

1. Autoriteti kompetent njeh, për qëllime të aksesit dhe ushtrimit të një profesioni të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, dëshmitë e kualifikimeve profesionale të fituara në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian mbi bazën e një kuadri të përbashkët të formimit, të përcaktuar me akt të deleguar të Komisionit Evropian, me të njëjtin efekt si dëshmitë e kualifikimeve të lëshuara sipas legjislacionit shqiptar.

2. Njohja sipas paragrafit 1 zbatohet vetëm nëse:

- a) kuadri i përbashkët i formimit është miratuar nga Komisioni Evropian sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian;
 - b) profesioni në fjalë është i rregulluar në Republikën e Shqipërisë.
3. Kuadri i përbashkët i formimit nuk zëvendëson programet kombëtare të formimit të parashikuara në legjislacionin shqiptar, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj të posaçëm.
4. Republika e Shqipërisë nuk është e detyruar të zbatojë një kuadër të përbashkët të formimit të miratuar nga Komisioni Evropian dhe të zbatojë regjimin e njohjes automatike nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:
- a) mungojnë institucione arsimore ose struktura të përshtatshme për të ofruar formimin përkatës;
 - b) zbatimi i kuadrit do të ndikonte negativisht në organizimin e sistemit arsimor ose të formimit profesional në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - c) ekzistojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet përmbajtjes së kuadrit dhe programeve kombëtare të formimit, të cilat përbëjnë rrezik serioz për rendin publik, sigurinë publike, shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit ose sigurinë e përfituesve të shërbimeve.
5. Ministria përgjegjëse për çështje të profesioneve të rregulluara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e një akti të deleguar të Komisionit Evropian për një kuadër të përbashkët të formimit:
- a) njofton Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare për titujt profesionalë dhe kualifikimet që përputhen me kuadrin; ose
 - b) njofton përdorimin e një prej përjashtimeve të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës.
6. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për specialitetet e profesioneve të rregulluara, nëse aksesimi dhe ushtrimi i specialitetit në fjalë është objekt rregullimi në legjislacionin shqiptar dhe specialiteti nuk është i përfshirë në një sistemin e njohjes automatike sipas kreut IV të këtij ligji.

Neni 66

Njohja automatike mbi bazën e provimit të përbashkët të formimit

1. Autoriteti kompetent njeh, për qëllime të aksesit dhe ushtrimit të një profesioni të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, të drejtën për ushtrim profesional për çdo individ që ka përfunduar me sukses një provim të përbashkët të formimit në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, i përcaktuar me akt të deleguar të Komisionit Evropian, me të njëjtin efekt si dëshmitë e kualifikimeve të fituara sipas legjislacionit shqiptar.
2. Njohja sipas paragrafit 1 zbatohet vetëm nëse:
 - a) provimi i përbashkët i formimit është miratuar nga Komisioni Evropian sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian;
 - b) profesioni në fjalë është i rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

3. Republika e Shqipërisë nuk është e detyruar të organizojë një provim të përbashkët të formimit dhe të zbatojë regjimin e njohjes automatike, nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

- a) profesioni përkatës nuk është i rregulluar në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) përmbajtja e provimit nuk ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e shëndetit publik ose sigurinë e përfituesve të shërbimit në territorin shqiptar;
- c) zbatimi i provimit do të krijonte pengesa të pajustificuara në aksesin në profesion, në krahasim me kërkesat e legjislacionit shqiptar.

4. Ministria përgjegjëse për çështje të profesioneve të rregulluara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e një akti të deleguar të Komisionit Evropian për një provim të përbashkët të formimit:

- a) njofton Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare për kapacitetin e disponueshëm për organizimin e provimit në territorin e Republikës së Shqipërisë; ose
- b) njofton përdorimin e një prej përjashtimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, së bashku me arsyetimin përkatës.

KREU VI

DISPOZITA PROCEDURALE MBI NJOHJEN PËR VENDOSJEN NË SHQIPËRI

Neni 67

Procedura e njohjes

1. Profesionisti paraqet aplikim për njohjen e kualifikimeve profesionale pranë autoritetit kompetent përkatës.

2. Autoriteti kompetent konfirmon marrjen e aplikimit brenda një muaji dhe njofton profesionistin për çdo dokumentacion të munguar.

3. Procedura e shqyrtimit të aplikimit përfundon sa më shpejt që të jetë e arsyeshme dhe jo më vonë se tre muaj nga data e paraqitjes së dosjes së plotë. Ky afat mund të shtyhet me një muaj në rastet që lidhen me Kreun II dhe III të këtij Titulli.

4. Vendimi i arsyetuar i autoritetit kompetent, ose mosmarrja e tij brenda afatit, mund të ankimohet sipas legjislacionit të përgjithshëm për procedurat administrative dhe gjyqësore.

Neni 68

Dokumentet dhe certifikatat e nevojshme

1. Për qëllime të shqyrtimit të aplikimit për njohjen e kualifikimeve profesionale sipas këtij Titulli, autoriteti kompetent mund të kërkojë nga profesionisti paraqitjen e dokumenteve të mëposhtme:

- a) dëshmi të shtetësisë;

b) kopje të vërtetimit të kompetencës profesionale ose të kualifikimit profesional që jep akses në profesionin përkatës, si dhe dëshmi të përvojës profesionale, sipas rastit. Autoriteti kompetent mund t'i kërkojë profesionistit që të paraqesë informacion shtesë lidhur me përmbajtjen e formimit të ndjekur, në masën që është e nevojshme për të përcaktuar ekzistencën e dallimeve thelbësore me formimin kombëtar të kërkuar. Kur është e pamundur për profesionistin të paraqesë këtë informacion, autoriteti kompetent u drejtohet pikës së vetme të kontaktit, autoritetit kompetent ose çdo organi tjetër përkatës në shtetin anëtar të origjinës së kualifikimit;

c) për profesionet e mbuluara nga Kreu III i këtij Titulli, certifikatë mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e aktivitetit profesional të ushtruar, e lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës ose nga shteti tjetër anëtar nga i cili vjen aplikanti;

ç) dokument që vërteton emrin ose reputacionin e mirë, mungesën e falimentit, si dhe mungesën e ndalimeve apo pezullimeve nga ushtrimi i profesionit për shkak të shkeljeve të rënda profesionale ose të dënimeve penale të lidhura me ushtrimin e profesionit, të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ose të një shteti tjetër anëtar nga i cili vjen aplikanti. Në rastet kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës ose të shtetit tjetër anëtar nuk lëshojnë dokumente të tilla, ato zëvendësohen me një deklaratë nën betim ose, në shtetet ku nuk parashikohet një formë e tillë, me një deklaratë solemne të bërë përpara një autoriteti gjyqësor ose administrativ kompetent, ose, sipas rastit, përpara një noteri apo organi profesional të kualifikuar në shtetin përkatës. Këtyre deklaratave u bashkëlidhet një certifikatë që vërteton autenticitetin e deklaratës përkatëse, e lëshuar nga autoriteti që ka marrë deklaratën;

d) dokument që dëshmon gjendjen shëndetësore fizike ose mendore, kur kërkohet nga legjislacioni kombëtar për shtetasit shqiptarë. Në mungesë të një dokumenti të tillë në shtetin anëtar të origjinës, pranohet certifikatë nga autoritet kompetent në atë shtet;

dh) dëshmi që vërteton gjendjen financiare dhe sigurimin ndaj përgjegjësisë profesionale, kur këto kërkohen për shtetasit shqiptarë, të lëshuara nga bankat apo shoqëritë e sigurimit të çdo shteti anëtar;

e) dëshmi që konfirmon mungesën e pezullimeve të përkohshme apo përfundimtare nga ushtrimi i profesionit ose mungesën e dënimeve penale, kur kërkohet për shtetasit shqiptarë.

2. Për profesionet që përfshihen në sistemin e njohjes automatike sipas Kreut IV të këtij Titulli, profesionisti paraqet gjithashtu një certifikatë të lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës, e cila vërteton se kualifikimi profesional i paraqitur përfshihet në fushën e zbatimit të këtij sistemi.

3. Dokumentet e përmendura në paragrafin 1, nënparagrafët (ç), (d) dhe (dh), duhet të jenë lëshuar brenda tre muajve nga data e dorëzimit.

4. Të gjitha dokumentet pranohen në formatin dhe gjuhën zyrtare të shtetit anëtar të origjinës ose shtetit tjetër anëtar ku janë lëshuar. Autoriteti kompetent mund të kërkojë përkthimin në gjuhën shqipe, nëse është e nevojshme për shqyrtimin e aplikimit.

5. Autoritetet, institucionet dhe personat juridikë që marrin dokumentacionin, garantojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të marrë.

Neni 69

Verifikimi i dokumentacionit dhe bashkëpunimi administrativ

1. Në rast dyshimi të arsyeshëm mbi autenticitetin e dokumenteve ose certifikatave të paraqitura sipas nenit 18 të këtij ligji, autoriteti kompetent mund të kërkojë nga autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës:
 - a) konfirmimin e vërtetësisë së dokumenteve dhe certifikatave që provojnë kualifikimet profesionale;
 - b) konfirmimin se profesionisti, për profesionet e mbuluara nga Kreu IV i Titullit III të këtij ligji, përmbush kushtet minimale të formimit.
2. Në rast se dokumenti i kualifikimit profesional është lëshuar nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar, por formimi është ndjekur pjesërisht ose tërësisht në një shtet anëtar tjetër, në rast dyshimi të arsyeshëm, autoriteti kompetent shqiptar mund të verifikojë tek autoriteti kompetent i shtetit anëtar të origjinës që ka lëshuar diplomën:
 - a) nëse kursi i formimit është certifikuar zyrtarisht nga institucioni arsimor i shtetit anëtar ku diploma është lëshuar;
 - b) nëse kualifikimi profesional i lëshuar është i barasvlershëm me atë që do të ishte lëshuar po të ishte ndjekur i gjithë formimi në shtetin ku diploma është lëshuar;
 - c) nëse kualifikimi profesional jep të drejtë ushtrimi të profesionit në territorin e atij shteti.
2. Në rast se ka dyshime të arsyeshme, autoriteti kompetent shqiptar mund të kërkojë konfirmim nga autoriteti kompetent i çdo shteti anëtar lidhur me faktin nëse aplikanti është ose jo i pezulluar apo i ndalohet ushtrimi i profesionit si pasojë e shkeljeve të rënda profesionale apo dënimeve penale që lidhen me veprimtarinë profesionale.
3. Shkëmbimi i informacionit mes autoriteteve kompetente shqiptare dhe atyre të shteteve anëtare realizohet përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI).
4. Në rast se legjislacioni shqiptar parashikon bërjen e një betimi apo deklarate solemne nga shtetasit shqiptarë për qasje në një profesion të rregulluar, dhe kjo formulë nuk mund të përdoret nga shtetasit shteteve anëtare, autoritetet kompetente shqiptare sigurojnë që aplikantët e huaj të mund të përdorin një formulim të barasvlershëm.

TITULLI IV

KARTA PROFESIONALE EVROPIANE

Neni 70

Karta Profesionale Evropiane

1. Për profesionet e rregulluara për të cilat Komisioni Evropian ka miratuar aktet zbatuese përkatëse, individi që zotëron një kualifikim profesional ka të drejtë të kërkojë pajisjen me Kartën Profesionale Evropiane. Kjo procedurë përbën një alternativë ndaj procedurave për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve ose për vendosje, të parashikuara në këtë ligj.

2. Aplikanti ka të drejtë të zgjedhë ndërmjet përdorimit të Kartës Profesionale Evropiane dhe procedurave të përcaktuara në titujt II dhe III të këtij ligji.

3. Mbajtësi i Kartës Profesionale Evropiane gëzon të gjitha të drejtat që burojnë nga dispozitat e këtij ligji.

4. Në rastin e ofrimit të përkohshëm dhe të rastësishëm të shërbimeve që nuk përfshihen në kontrollin paraprak sipas nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit të origjinës, lëshon Kartën Profesionale Evropiane në përputhje me nenin 71 të këtij ligji. Karta, në këtë rast, përbën deklaratë në kuptim të nenit 10 të këtij ligji.

5. Në rastin e vendosjes ose të ofrimit të shërbimeve sipas nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit të origjinës, përgatit dosjen IMI të aplikantit sipas procedurës së përcaktuar në nenin 72 të këtij ligji. Në këto raste, karta lëshohet nga autoriteti kompetent i shtetit pritës, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

6. Pajisja me Kartën Profesionale Evropiane për qëllime vendosjeje nuk përbën të drejtë automatike për ushtrimin e profesionit në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur për ushtrimin e tij kërkohet regjistrim, autorizim ose procedura të tjera kontrolli të vlefshme përpara hyrjes në përdorim të kartës për atë profesion.

7. Autoritetet kompetente dhe qendrat e asistencës shqiptare marrin masa për informimin e qytetarëve dhe profesionistëve mbi funksionimin, përdorimin dhe përfitimet e Kartës Profesionale Evropiane për profesionet përkatëse, si dhe për sigurimin e një trajtimi të paanshëm, objektiv dhe të shpejtë të aplikimeve.

8. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për profesionet e rregulluara:

a) përcakton autoritetet kompetente përgjegjëse për shqyrtimin dhe lëshimin e Kartës Profesionale Evropiane;

b) miraton aktet nënligjore për procedurat, formatin dhe kriteret për shqyrtimin e aplikimeve dhe lëshimin e kartës;

c) përcakton tarifat administrative për pajisjen me kartë, të cilat duhet të jenë të arsyeshme, proporcionale dhe në përputhje me kostot reale që mbartin autoritetet kompetente shqiptare si shtet i origjinës ose shtet pritës, pa përbërë pengesë për aplikimin.

Neni 71

Procedura për aplikimin dhe krijimin e dosjes IMI

1. Autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit të origjinës, siguron që individit që zotëron një kualifikim profesional të mund të paraqesë kërkesën për Kartën Profesionale Evropiane nëpërmjet mjetit elektronik të vënë në dispozicion nga Komisioni Evropian, i cili krijon automatikisht dosjen përkatëse në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI).
2. Kur lejohet paraqitja e kërkesës edhe në formë të shkruar, autoriteti kompetent merr masat për të krijuar dosjen IMI dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet përkatëse në lidhje me komunikimin me aplikantin dhe lëshimin e kartës.
3. Kërkesa për Kartën Profesionale Evropiane shoqërohet me dokumentet e përcaktuara në aktin nënligjor të miratuar për këtë qëllim.
4. Brenda një jave nga marrja e aplikimit, autoriteti kompetent shqiptar:
 - a) konfirmon marrjen e kërkesës dhe njofton aplikantin për çdo dokument të munguar;
 - b) lëshon çdo certifikatë mbështetëse të kërkuar nga ky ligj ose aktet nënligjore përkatëse;
 - c) verifikon nëse aplikanti është i vendosur ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - ç) verifikon vlefshmërinë dhe vërtetësinë e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare.
5. Në rast të dyshimeve të justifikuara, autoriteti kompetent shqiptar konsultohet me institucionin përkatës dhe mund të kërkojë nga aplikanti paraqitjen e kopjeve të certifikuara të dokumenteve përkatëse.
6. Në rast të aplikimeve të përsëritura nga i njëjti profesionist, autoritetet kompetente shqiptare nuk kërkojnë riparaqitjen e dokumenteve që ndodhen tashmë në dosjen IMI dhe që mbeten të vlefshme.

Neni 72

Karta Profesionale Evropiane për ushtrimin e përkohshëm dhe të rastësishëm të profesionit

1. Në rastin e ofrimit të përkohshëm dhe të rastësishëm të shërbimeve që nuk përfshihen në kontrollin paraprak, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit të origjinës, verifikon kërkesën dhe dokumentet mbështetëse të përfshira në dosjen IMI dhe lëshon Kartën Profesionale Evropiane brenda tre javëve. Kjo periudhë fillon nga:
 - a) marrja e dokumenteve të munguara të përmendura në nenin 71, paragrafi 4, nënparagrafi “a”; ose
 - b) përfundimi i afatit njëjavor të përmendur në atë pikë, nëse nuk kërkohen dokumente shtesë.Pas lëshimit të kartës, autoriteti kompetent shqiptar e transmeton menjëherë atë tek autoritetet kompetente të çdo shteti pritës të përfshirë në kërkesë dhe njofton aplikantin. Për një periudhë tetëmbëdhjetë (18) mujore nga data e transmetimit, autoritetet kompetente të shteteve pritëse nuk mund të kërkojnë deklaratë të re sipas nenit 8 të këtij ligji.

2. Vendimi i autoritetit kompetent shqiptar për lëshimin e kartës ose mungesa e tij brenda afatit trejavor të parashikuar në paragrafin 1 është objekt ankimi në përputhje me legjislacionin për procedurat administrative.
3. Nëse mbajtësi i Kartës Profesionale Evropiane dëshiron:
 - a) të ofrojë shërbime në shtete të tjera anëtare të ndryshme nga ato të përfshira në kërkesën fillestare, ose
 - b) të vazhdojë ofrimin e shërbimeve 18muaj pas trasmetimit të KPE-së tek autoritetet kompetente të shtetit pritës, ai informon autoritetin kompetent shqiptar dhe paraqet çdo informacion mbi ndryshimet materiale në të dhënat e dokumentuara në dosjen IMI, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të nxjerra për këtë qëllim. Autoriteti kompetent përditëson kartën dhe e transmeton atë tek autoritetet kompetente të shteteve pritëse përkatëse. Karta Profesionale Evropiane është e vlefshme në të gjithë territorin e shteteve pritëse për aq kohë sa mbajtësi i saj mban të drejtën për ushtrimin e profesionit, mbi bazën e dokumenteve dhe informacionit të përfshirë në dosjen IMI.

Neni 73

Karta Profesionale Evropiane për vendosje dhe për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve

1. Kur kërkesa për Kartën Profesionale Evropiane paraqitet për qëllime vendosjeje ose për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit të origjinës, brenda një muaji:

- a) verifikon vlefshmërinë dhe vërtetësinë e dokumenteve të përfshira në dosjen IMI;
- b) transmeton kërkesën tek autoriteti kompetent i shtetit pritës;
- c) njofton aplikantin për statusin e kërkesës.

Afati njëmuajor fillon:

- i) nga marrja e dokumenteve të munguara të parashikuara në nenin 71, paragrafi 4, nënparagrafi “a”; ose
- ii) me përfundimin e afatit njëjavor në mungesë të kërkesës për dokumente shtesë.

2. Në rastet e parashikuara në nenet 24, 28, 65 dhe 66 të këtij ligji, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit pritës, shqyrton kërkesën dhe vendos për lëshimin e Kartës Profesionale Evropiane brenda një muaji nga marrja e saj.

Në rast dyshimesh të justifikuara, autoriteti mund të kërkojë informacion shtesë ose dokument të certifikuar nga shteti i origjinës. Shteti i origjinës e dërgon informacionin brenda dy javësh nga kërkesa. Afati i shqyrtimit nuk pezullohet, përveçse sipas paragrafit 5 të këtij neni.

3. Në rastet e parashikuara në nenet 10 dhe 22 të këtij ligji, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit pritës, vendos për lëshimin e kartës ose për vendosjen e masave kompensuese brenda dy muajve nga marrja e kërkesës.

Në rast dyshimesh të justifikuara, kërkohet informacion shtesë ose dokument i certifikuar nga shteti i origjinës, i cili përgjigjet brenda dy javësh. Afati i shqyrtimit nuk pezullohet, përveçse sipas paragrafit 5 të këtij neni.

4. Në mungesë të informacionit të domosdoshëm nga shteti i origjinës ose aplikanti, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit pritës, mund të refuzojë lëshimin e kartës. Vendimi i refuzimit jepet me arsyetim të posaçëm.

Kur autoriteti kompetent shqiptar, duke vepruar në cilësinë e shtetit pritës:

a) nuk merr vendim brenda afatit njëmuajor ose dymujor, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3; ose

b) nuk organizon testin e aftësisë në përputhje me nenin 10 të këtij ligji,

Karta Profesionale Evropiane konsiderohet e lëshuar dhe transmetohet automatikisht nëpërmjet IMI-së.

Autoriteti kompetent mund ta zgjasë një herë afatin për lëshimin automatik të Kartës me dy javë, kur kjo është rreptësisht e nevojshme, veçanërisht për arsye të shëndetit publik ose sigurisë së përfituesve të shërbimeve. Aplikanti njoftohet për zgjatjen dhe arsyet përkatëse.

6. Veprimet e ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si shtet anëtar i origjinës, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, zëvendësojnë çdo kërkesë për njohjen e kualifikimeve profesionale sipas legjislacionit kombëtar të shtetit anëtar pritës.

Neni 74

Përpunimi dhe aksesimi i të dhënave në lidhje me Kartën Profesionale Evropiane

1. Autoritetet kompetente shqiptare, në cilësinë e shtetit të origjinës ose të shtetit pritës, përditësojnë në kohë dosjen përkatëse në Sistemin IMI me çdo informacion mbi masa disiplinore apo sanksione penale që kanë sjellë ndalim ose kufizim të ushtrimit të aktivitetit profesional të mbajtësit të Kartës Profesionale Evropiane.

Gjatë përpunimit të të dhënave, respektohen dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve të tjera përkatëse. Informacioni i përditësuar përfshin gjithashtu dhe fshirjen e të dhënave të panevojshme. Autoritetet që kanë akses në dosjen IMI dhe mbajtësi i kartës njoftohen menjëherë për çdo përditësim.

Kjo dispozitë nuk cenon detyrimet për lëshimin e sinjaleve të parashikuara në nenin 92 të këtij ligji.

2. Përditësimet e të dhënave sipas paragrafit 1 përfshijnë vetëm informacionin e mëposhtëm:

a) identitetin e profesionistit;

b) profesionin përkatës;

c) autoritetin kombëtar ose gjykatën që ka vendosur ndalimin ose kufizimin;

ç) përmbajtjen dhe shtrirjen e ndalimit ose kufizimit;

d) kohëzgjatjen e ndalimit ose kufizimit.

3. Aksesimi në dosjen IMI kufizohet vetëm për autoritetet kompetente shqiptare dhe autoritetet kompetente të shtetit anëtar përkatës të origjinës ose të shtetit anëtar pritës, sipas rastit,

në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Mbajtësi i Kartës ka të drejtë, me kërkesë, të informohet për përmbajtjen e dosjes përkatëse IMI.

4. Informacioni i përfshirë në Kartën Profesionale Evropiane kufizohet vetëm në të dhëna që vërtetojnë të drejtën e mbajtësit për të ushtruar profesionin përkatës, përfshirë: emrin, mbiemrin, datën dhe vendin e lindjes, profesionin, kualifikimet formale, regjimin e zbatueshëm të njohjes, autoritetet kompetente, numrin e kartës, elementët e sigurisë dhe referencën në dokumentin e identifikimi të vlefshëm.

Përvoja profesionale dhe masat kompensuese përfshihen vetëm në dosjen IMI, jo në kartën e lëshuar.

5. Të dhënat personale në dosjen IMI përpunohen për aq kohë sa është e nevojshme për procedurën e njohjes dhe si provë për përfundimin e saj ose për dorëzimin e deklaratës sipas nenit 8 të këtij ligji.

Mbajtësi i kartës ka të drejtë në çdo kohë dhe pa pagesë të kërkojë:

- a) korrigjimin e të dhënave të pasakta ose të paplota;
- b) fshirjen ose bllokimin e dosjes përkatëse IMI.

Kjo e drejtë i komunikohet mbajtësit në momentin e lëshimit të kartës dhe i rikujtohet automatikisht çdo dy vjet nëpërmjet sistemit IMI, kur aplikimi është bërë online.

Në rast kërkesë për fshirjen e dosjes IMI të lidhur me kartën e lëshuar për qëllime vendosjeje ose për ushtrimin e profesionit sipas nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kompetent shqiptar, në cilësinë e shtetit pritës, lëshon dëshmi për njohjen e kualifikimeve profesionale të mbajtësit.

6. Në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, autoritetet kompetente shqiptare konsiderohen kontrollues të të dhënave në kuptim të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Pa paragjykuar kufizimin e aksesit sipas paragrafit 3, autoritetet kompetente shqiptare sigurojnë që punëdhënësit, autoritetet publike dhe palët e interesuara të mund të verifikojnë vlefshmërinë e kartës së paraqitur nga mbajtësi i saj.

TITULLI V

RREGULLA TË HOLLËSISHME PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË NJOHUR

Neni 75

Njohja e gjuhës shqipe

1. Profesionistët që përfitojnë nga njohja e kualifikimeve profesionale sipas këtij ligji duhet të zotërojnë njohuritë e domosdoshme të gjuhës shqipe, të nevojshme për ushtrimin e profesionit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti kompetent mund të ushtrojë kontroll mbi njohuritë e gjuhës shqipe të profesionistit vetëm nëse:

- a) ushtrimi i profesionit përkatës ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë e pacientit;
ose
 - b) ekzistojnë dyshime serioze dhe konkrete mbi mospërputhjen e njohurive gjuhësore të profesionistit me kërkesat e ushtrimit të veprimtarisë profesionale.
3. Kontrolli sipas paragrafit 2 mund të ushtrohet vetëm pas:
- a) lëshimit të Kartës Profesionale Evropiane, në përputhje me këtë ligj;
ose
 - b) përfundimit të procedurës për njohjen e kualifikimeve profesionale, sipas këtij ligji.
4. Çdo kontroll i njohurive gjuhësore duhet të jetë i justifikuar, i domosdoshëm dhe proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e profesionit që do të ushtrohet.
5. Mungesa e njohurive të gjuhës shqipe nuk mund të shërbejë si bazë për refuzimin ose shtyrjen e vendimit për njohjen e kualifikimit profesional, me përjashtim të rasteve kur zotërimi i gjuhës shqipe përbën pjesë të përmbajtjes së vetë kualifikimit profesional.
6. Si mjete prove për njohjen e gjuhës shqipe, veçanërisht mund të pranohen, sipas rastit:
- a) diplomë ose certifikatë e përfituar në gjuhën shqipe;
 - b) dokument zyrtar që vërteton njohuritë gjuhësore, i lëshuar nga institucion i njohur kombëtar ose ndërkombëtar;
 - c) dëshmi për përvojë profesionale në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - ç) intervistë ose provim gjuhësor, kur dokumentacioni i paraqitur është i paplotë ose i pasaktë.
7. Profesionisti ka të drejtën të ankimojë çdo vendim për verifikimin gjuhësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 76

Përdorimi i titujve akademikë

1. Profesionistët që përfitojnë nga njohja e kualifikimeve profesionale sipas këtij ligji gëzojnë të drejtën të përdorin titujt akademikë të përfituar në një shtet anëtar tjetër të Bashkimit Evropian, së bashku me formën e shkurtuar të tyre, në gjuhën origjinale të atij shteti.
2. Autoritetet kompetente shqiptare mund të kërkojnë që përdorimi i titullit të shoqërohet me emrin dhe adresën e institucionit ose trupës që ka lëshuar titullin përkatës.
3. Kur titulli akademik i përfituar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngatërrohet me një titull që, sipas legjislacionit shqiptar, kërkon formim shtesë të papërmbushur nga profesionisti, autoritetet kompetente mund të kërkojnë përdorimin e tij në një formë të përshtatur dhe të shoqëruar me sqarim për të shmangur çdo keqkuptim me publikun.

Neni 77

Miratimi nga fondet e sigurimeve shëndetësore

Autoritetet kompetente nuk mund të kërkojnë nga mbajtësit e dëshmive të kualifikimeve profesionale të mjekut dhe stomatologut, të fituara në shtete të tjera anëtare, përfundimin e periudhave shtesë të formimit në shërbim ose përvojës profesionale me qëllim përfitimin e miratimit nga fondet e sigurimeve shëndetësore në Shqipëri.

Neni 78

Njohja e praktikës profesionale

1. Kur aksesimi në profesion të rregulluar në Shqipëri ose ushtrimi i tij është i kushtëzuar me përfundimin e një periudhe praktike profesionale, autoriteti kompetent njeh praktikën e kryer në një shtet anëtar tjetër dhe mund të marrë në konsideratë praktikat profesionale të kryera në një vend të tretë, për aq sa është në përputhje me udhëzimet e publikuara sipas paragrafit 4 të këtij neni.

2. Autoritetet kompetente mund të përcaktojnë, me akte nënligjore, një kufi të arsyeshëm mbi kohëzgjatjen e pjesës së praktikës që mund të kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Njohja e praktikës profesionale nuk përjashton kërkesat ekzistuese për kalimin e provimeve ose për përfundimin e formimeve të tjera të nevojshme për ushtrimin e profesionit përkatës në Shqipëri.

4. Autoritetet kompetente publikojnë udhëzime të detajuara për mënyrën e organizimit, mbikëqyrjes dhe njohjes së praktikës profesionale të kryer në një shtet anëtar tjetër ose në një vend të tretë, përfshirë rolin, përgjegjësitë dhe kriteret për mbikëqyrësin e praktikës.

TITULLI VI

VLERËSIMI I PROPORCIONALITETIT PËR PROFESIONET E RREGULLUARA

Neni 79

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Qëllimi i këtij titulli është të përcaktojë kuadrin rregullator për kryerjen e vlerësimit paraprak të proporcionalitetit, përpara miratimit të dispozitave të reja ose ndryshimit të dispozitave ekzistuese në një akt ligjor, nënligjor ose administrativ që kufizojnë aksesin ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, me qëllim sigurimin e funksionimit të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit.

2. Ky titull nuk cënon kompetencën e autoriteteve për të vendosur nëse një profesion rregullohet apo mënyrën e rregullimit të tij, në mungesë të harmonizimit nga legjislacioni i Bashkimit Evropian. Këto vendime ushtrohen në përputhje me parimet e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

3. Dispozitat e këtij titulli zbatohen për çdo dispozitë të re ose të ndryshuar në legjislacionin kombëtar që kufizon qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar apo një nga format e ushtrimit të tij, përfshirë përdorimin e titullit profesional dhe veprimtaritë që lejohen nëpërmjet tij, në fushën e zbatimit të këtij ligji.

4. Dispozitat e këtij titulli nuk zbatohen për ato profesione për të cilat kërkesat specifike për rregullimin janë përcaktuar në një akt të posaçëm të Bashkimit Evropian që nuk lejon zgjedhje në mënyrën e transpozimit nga shtetet anëtare.

Neni 80

Detyrimi për vlerësimin paraprak të proporcionalitetit dhe monitorimi pasues

1. Përpara miratimit të çdo dispozite të re ose të ndryshuar, në një akt ligjor, nënligjor ose administrativ që parashikon kufizime për qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar apo një forme të ushtrimit të tij, autoriteti kompetent dhe çdo organ tjetër përgjegjës për rregullimin e profesioneve të rregulluara kryen një vlerësim paraprak të proporcionalitetit të masës së propozuar.

2. Vlerësimi i parashikuar në paragrafin 1 zbatohet posaçërisht për dispozitat që:

- a) kufizojnë përdorimin e titullit profesional;
- b) kufizojnë ushtrimin e një ose më shumë veprimtarive të rezervuara për një profesion të rregulluar;
- c) kufizojnë qasjen në një profesion të rregulluar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

3. Vlerësimi i proporcionalitetit:

- a) përgatitet në mënyrë objektive dhe të pavarur;
- b) kryhet në përpjesëtim me natyrën, përmbajtjen dhe ndikimin e masës së propozuar;
- c) shoqërohet me një shpjegim të argumentuar dhe të hollësishëm, që lejon vlerësimin e përputhshmërisë me parimin e proporcionalitetit;
- ç) mbështetet në të dhëna cilësore dhe, kur është e mundur dhe e përshtatshme, edhe në të dhëna sasiore që mund të përfshijnë të dhëna mbi ndikimin në punësim apo hyrjen në treg.

4. Pas miratimit të dispozitave të reja ose të ndryshuara, autoriteti kompetent monitoron zbatimin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke marrë parasysh zhvillimet që kanë ndodhur pas hyrjes së tyre në fuqi.

Neni 81

Parimi i mosdiskriminimit

1. Kur propozojnë ose miratojnë dispozita të reja apo ndryshime të dispozitave ekzistuese në një akt ligjor, nënligjor ose administrativ, që kufizojnë qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, autoritetet kompetente sigurojnë që këto dispozita të mos jenë në asnjë mënyrë diskriminuese, drejtpërdrejt apo tërthorazi, mbi bazë të shtetësisë apo vendbanimit.

2. Autoritetet kompetente marrin masa për të shmangur çdo formë të mundshme diskriminimi të tillë gjatë procesit të vlerësimit dhe miratimit të masave përkatëse, përfshirë kryerjen e vlerësimit të proporcionalitetit sipas nenit 80 të këtij ligji.

Neni 82

Justifikimi bazuar ne objektiva të interesit publik

1. Çdo dispozitë e re ose e ndryshuar në një akt ligjor, nënligjor ose administrativ, që kufizon qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, justifikohet vetëm nëse synon mbrojtjen e një objektivi të interesit publik.

2. Objektivat e interesit publik përfshijnë, në veçanti:

- a) rendin publik, sigurinë publike ose shëndetin publik;
- b) ruajtjen e ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore;
- c) mbrojtjen e konsumatorëve, përfituesve të shërbimeve dhe punëmarrësve;
- ç) sigurimin e funksionimit të drejtë të sistemit të drejtësisë;
- d) garantimin e drejtësisë ë marrëdhëniet tregtare;
- dh) luftën ndaj mashtrimit dhe parandalimin e evazionit fiskal apo shmangies ndaj detyrimeve tatimore;
- e) sigurimin e mbikëqyrjes efektive tatimore;
- ë) sigurinë në transport;
- f) mbrojtjen e mjedisit, përfshirë mjedisin urban;
- g) shëndetin e kafshëve;
- gj) pronësinë intelektuale;
- h) ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë historike dhe artistike kombëtare;
- i) objektivat e politikës sociale dhe të politikës kulturore.

3. Nuk përbëjnë objektiva të mbrojtura të interesit publik, në kuptim të këtij neni, arsyet me natyrë thjesht ekonomike apo administrative.

Neni 83

Kriteret për vlerësimin e proporcionalitetit

1. Çdo dispozitë e re ose e ndryshuar që kufizon qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar lejohet vetëm nëse është e përshtatshme dhe e nevojshme për arritjen e objektivit të ndjekur.

2. Autoritetet kompetente vlerësojnë posaçërisht:

- a) natyrën e rreziqeve që lidhen me objektivat e interesit publik, veçanërisht ndaj përfituesve të shërbimeve, përfshirë konsumatorët, profesionistëve apo palëve të treta;

b) nëse rregullat ekzistuese, të natyrës së veçantë ose të përgjithshme, si ato të përfshira në legjislacionin për sigurinë e produkteve apo mbrojtjen e konsumatorit, janë të pamjaftueshme për arritjen e objektivit të synuar;

c) përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë e dispozitës me objektivin, dhe nëse kjo reflekton objektivin në mënyrë sistematike e të qëndrueshme, duke adresuar risqet e identifikuara në mënyrë të ngjashme siç për veprimtari të tjera të krahasueshme me ato objekt rregullimi;

ç) ndikimin në lirinë e lëvizjes së personave dhe shërbimeve brenda Bashkimit Evropian, në zgjedhjet e konsumatorëve dhe cilësinë e shërbimeve;

d) mundësinë e përdorimit të mjeteve më pak kufizuese, sidomos nëse objektivi ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e konsumatorëve, ne veçanti kur rreziqet e identifikuara kufizohen në marrëdhënien ndërmjet profesionistit dhe konsumatorit, dhe për rrjedhojë nuk ndikojnë negativisht palët e treta;

dh) nëse masa e re ose e ndryshuar, në kombinim me kërkesa ekzistuese, rezulton në një kufizim që shkon përtej asaj që është e nevojshme.

3. Për masat që rregullojnë profesionet e shëndetësisë dhe kanë pasoja për sigurinë e pacientëve, autoritetet kompetente marrin në konsideratë nevojën për të garantuar një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

Neni 84

Aspekte shtesë të vlerësimit të proporcionalitetit

1. Në varësi të natyrës dhe përmbajtjes së dispozitës, autoritetet vlerësojnë gjithashtu:

a) lidhjen ndërmjet fushës së veprimtarisë së rezervuar dhe kualifikimit profesional të kërkuar;

b) lidhjen ndërmjet kompleksitetit të detyrave dhe nevojës për zotërim të kualifikimeve specifike, përfshirë nivelin, natyrën dhe kohëzgjatjen e formimit ose përvojës;

c) mundësinë për të përfituar kualifikimin profesional nëpërmjet rrugëve alternative;

ç) nëse dhe pse veprimtaritë e rezervuara për një profesion të caktuar mund ose nuk mund të ndahen me profesione të tjera;

d) shkallën e autonomisë në ushtrimin e profesionit të rregulluar dhe ndikimin e strukturës së organizimit dhe mbikëqyrjes profesionale në arritjen e objektivit, sidomos kur veprimtaria profesionale ushtrohet nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e një profesionisti tjetër të kualifikuar;

dh) zhvillimet shkencore e teknologjike që mund të ndikojnë në asimetrinë e informacionit ndërmjet profesionistëve dhe konsumatorëve.

Neni 85

Ndikimi i kërkesave të kombinuara

1. Për vlerësimin sipas paragrafit dh) të nenit 84 të këtij ligji, autoritetet publike analizojnë veçanërisht efektet që shkaktohen nga kombinimi i masës së re ose të ndryshuar me një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme:

- a) veprimtari të rezervuara, tituj profesionalë të mbrojtur ose çdo formë tjetër rregullimi në kuptim të nenit 4 të këtij ligji;
- b) detyrimi për zhvillim të vazhdueshëm profesional;
- c) rregulla mbi organizimin e profesionit, etikën dhe mbikëqyrjen profesionale;
- ç) anëtarësimi i detyrueshëm në organizata profesionale ose regjistrimi apo autorizimi që kërkon zotërimin e kualifikimit specifik;
- d) kufizime sasiore, përfshirë në numrin e autorizimeve ose të personelit me kualifikim të caktuar për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse;
- dh) kërkesa mbi formën juridike apo strukturën e kapitalit që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e profesionit të rregulluar;
- e) kufizime territoriale;
- ë) ndalimi i ushtrimit të profesionit në bashkëpunim apo partneritet me të tjerë dhe rregullat mbi papajtueshmërinë profesionale;
- f) kërkesa për sigurim profesional;
- g) kërkesa për njohuri gjuhësore;
- gj) tarifa minimale apo maksimale të fiksuara për ushtrimin e profesionit;
- h) kërkesa për reklamimin e veprimtarisë profesionale.

Neni 86

Vlerësimi për ushtrimin e përkohshëm dhe rastësor të profesionit

1. Përpara miratimit të dispozitave që lidhen me ushtrimin e përkohshëm ose rastësor të profesionit sipas Titullit II të këtij ligji, autoritetet publike sigurojnë përputhshmërinë e kërkesave specifike me parimin e proporcionalitetit, veçanërisht në rastet e:

- a) regjistrimit të përkohshëm automatik ose anëtarësimit *pro forma* në një organizatë profesionale;
- b) deklaratës paraprake dhe dokumenteve mbështetëse sipas nenit 8 dhe 9 të këtij ligji, apo kërkesave të barasvlershme me to;
- c) tarifave apo kostove administrative për përpunimin e procedurave përkatëse.

2. Ky nen nuk zbatohet për masat që kanë si objekt sigurimin e kushteve të punës në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Kërkesat duhet të kufizohen vetëm në masat që janë të nevojshme për mbrojtjen e interesit publik dhe të jenë në përpjesëtim me qëllimin që synohet të arrihet.

Neni 87

Informimi dhe përfshirja e palëve të interesuara

1. Përpara miratimit të çdo dispozite të re ose ndryshimit të një dispozite ekzistuese, në një akt ligjor, nënligjor ose administrativ që kufizon qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, autoriteti kompetent siguron, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme, informimin paraprak të qytetarëve, përfituesve të shërbimeve dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë edhe ato që nuk janë anëtarë të profesionit të rregulluar përkatës.

2. Autoritetet kompetente sigurojnë pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara në procesin e hartimit të dispozitave sipas paragrafit 1, duke u ofruar atyre mundësinë për të paraqitur mendimet e tyre. Nëse vlerësohet e përshtatshme nga autoritetet kompetente, organizohen dhe ndiqen procedurat e konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për njoftimin dhe konsultimin publik.

3. Informacioni dhe dokumentet përkatëse, duke përfshirë draftin e masës, arsyetimin e saj dhe vlerësimin e proporcionalitetit sipas këtij Titulli, bëhen publikisht të disponueshme në mënyrë transparente, të kuptueshme dhe të aksesueshme lirisht.

Neni 88

Garancia për mjet juridik efektiv

1. Çdo person fizik ose juridik, i cili ndikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një dispozitë e re ose e ndryshuar që kufizon qasjen ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, ka të drejtë të kërkojë mjet juridik efektiv për vlerësimin e përputhshmërisë së kësaj mase me dispozitat e këtij Titulli.

2. Mjetet juridike jepen në përputhje me rregullat e procedurës administrative ose gjyqësore të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe sigurojnë mbrojtje të plotë dhe të paanshme të të drejtave dhe interesave legjitime të palëve të interesuara.

3. Autoritetet kompetente sigurojnë që informacioni mbi të drejtën për ankim dhe mbi procedurat përkatëse të jetë i qartë, i aksesueshëm lirisht dhe i disponueshëm publikisht, në përputhje me parimin e transparencës.

TITULLI VII

BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV, KOORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE TRANSPARENCA

Neni 89

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente

1. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë ngushtësisht dhe ofrojnë ndihmë të ndërsjellë me autoritetet kompetente të shteteve anëtare, për të lehtësuar zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të tij zbatuese. Kjo ndihmë përfshin shkëmbimin e informacionit dhe bashkërendimin e veprimeve për çështjet që lidhen me njohjen e kualifikimeve profesionale dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara.

2. Autoritetet kompetente shkëmbejnë informacione mbi masa disiplinore ose sanksione penale të marra ndaj profesionistëve, si dhe mbi çdo rrethanë tjetër serioze dhe specifike, e cila mund të ndikojë në ushtrimin e veprimtarive profesionale sipas këtij ligji, me homologët e tyre në shtetet anëtare të origjinës dhe ato pritës.

3. Në rast të marrjes së informacionit të tillë, autoriteti kompetent, në cilësinë e shtetit të origjinës:

- a) verifikon saktësinë e rrethanave të njoftuara;
- b) vendos mbi natyrën dhe shtrirjen e hetimeve të nevojshme;
- c) njofton autoritetin kompetent të shtetit pritës për konkluzionet e nxjerra dhe për çdo masë të ndërmarrë.

4. Informacioni i shkëmbyer sipas paragrafit 2 trajtohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garantohet konfidencialiteti i plotë i të dhënave.

5. Autoritetet kompetente përdorin sistemin IMI për qëllimet e përcaktuara në këtë nen.

Neni 90

Autoritetet kompetente dhe koordinatori shtetëror

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për profesionet e rregulluara, miraton me vendim listën e autoriteteve dhe institucioneve kompetente që ushtrojnë funksionet e mëposhtme:

- a) pranimin dhe lëshimin e dëshmive të kualifikimit profesional dhe dokumenteve të tjera mbështetëse sipas këtij ligji;
- b) marrjen e kërkesave dhe marrjen e vendimeve për njohjen e kualifikimeve profesionale;
- c) komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit për qëllime të zbatimit të këtij ligji, përmes sistemit IMI.

2. Lista e autoriteteve kompetente publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse dhe përditësohet rregullisht.

3. Këshilli i Ministrave emëron koordinatorin kombëtar për profesionet e rregulluara për koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve kompetente të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Koordinatori kombëtar ushtron këto detyra:

a) nxit dhe mbikëqyr zbatimin e njëtrajtshëm të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) mbledh dhe organizon informacionin mbi kushtet për akses dhe ushtrim të profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;

c) shqyrton dhe propozon për miratim kuadro të përbashkëta të formimit profesional dhe provime të përbashkëta të formimit me shtetet anëtare;

ç) shkëmben informacione dhe praktika të mira për zhvillimin e vazhduar profesional;

d) shkëmben përvoja për zbatimin e masave kompensuese, në bashkëpunim me autoritetet kompetente.

5. Për ushtrimin e detyrave sipas paragrafit 4, nënparagrafi “b”, koordinatori kombëtar bashkëpunon me qendrën e asistencës të përcaktuar në nenin 95 të këtij ligji.

6. Ministria përgjegjëse për profesionet e rregulluara njofton Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare lidhur me:

a) autoritetet dhe institucionet kompetente sipas këtij neni;

b) koordinatorin kombëtar dhe çdo ndryshim të statusit apo funksionit të tij.

Neni 91

Procedura e njoftimit për përjashtimin nga e drejta e zgjedhjes

1. Nëse autoriteti kompetent, për një profesion të caktuar, konsideron të nevojshme të shmangë detyrimin për t'i ofruar profesionistit të drejtën e zgjedhjes ndërmjet periudhës së përshtatjes dhe testit të përshtatshmërisë, ai njofton paraprakisht Koordinatorin Kombëtar për Profesionet e Rregulluara për këtë qëllim.

2. Koordinatori Kombëtar për Profesionet e Rregulluara, me vendim të posaçëm, miraton propozimin për përjashtim dhe informon menjëherë Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare përkatëse, duke paraqitur një justifikim të plotë dhe të arsyetuar për këtë përjashtim.

3. Përjashtimi nga e drejta e zgjedhjes mund të aplikohet vetëm nëse:

a) Komisioni Evropian nuk kundërshton këtë përjashtim brenda tre muajve nga data e marrjes së njoftimit të plotë; ose

b) Komisioni Evropian vendos shprehimisht të lejojë përjashtimin.

4. Në mungesë të përgjigjes nga Komisioni Evropian brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 3, përjashtimi konsiderohet i vlefshëm dhe zbatohet nga autoriteti kompetent në përputhje me vendimin përkatës të Koordinatorit Kombëtar për Profesionet e Rregulluara.

Neni 92

Mekanizmi i sinjalizimit ndërinstitutional

1. Autoritetet kompetente informojnë, përmes sistemit IMI, autoritetet kompetente të shteteve të tjera pjesëmarrëse për çdo profesionist ndaj të cilit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, është marrë një vendim nga një autoritet kompetent apo gjykatë për ndalimin apo kufizimin, tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, të ushtrimit të veprimtarisë profesionale të rregulluar.

2. Njoftimi sipas paragrafit 1 të këtij neni zbatohet për profesionistët që:

a) zotërojnë dëshmi kualifikimi të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 34 të këtij ligji;

b) zotërojnë certifikata që vërtetojnë përfundimin e formimit profesional që përmbush kushtet minimale të formimit për profesionet përkatëse, të përcaktuara në legjislacionin shqiptar për secilin profesion të rregulluar përkatës sipas së drejtës së Bashkimit Evropian, formimi i të cilëve ka filluar më herët se datat e dëshmimeve të kualifikimit përkatës, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 34 të këtij ligji.

c) gëzojnë të drejta të fituara të njohura sipas kreut IV të këtij titulli;

ç) ushtrojnë veprimtari që ndikojnë në sigurinë e pacientit;

d) ushtrojnë veprimtari që lidhen me edukimin e të miturve, përfshirë kujdesin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme, për sa kohë këto profesione janë të rregulluara në Republikën e Shqipërisë.

3. Sinjalizimi në sistemin IMI dërgohet jo më vonë se tre ditë kalendarike nga data e marrjes së vendimit përkatës dhe përmban vetëm informacionin e mëposhtëm:

a) identitetin e profesionistit;

b) emërtimin e profesionit përkatës;

c) identitetin e autoritetit ose të gjykatës që ka marrë vendimin;

ç) përshkrimin dhe shtrirjen e ndalimit ose kufizimit;

d) afatin e vlefshmërisë së masës.

4. Autoritetet kompetente dërgojnë, përmes sistemit IMI dhe brenda të njëjtit afat tre ditor, një sinjalizim për çdo rast kur një gjykatë shqiptare ka konstatuar se një profesionist që ka paraqitur kërkesë për njohje të një kualifikimi profesional ka përdorur dokumentacion të falsifikuar.

5. Në përfundim të ndalimit ose kufizimit, autoriteti kompetent shqiptar njofton pa vonesë autoritetet përkatëse të tjera përmes sistemit IMI, përfshirë datën e përfundimit të ndalimit apo kufizimit dhe çdo ndryshim të mëvonshëm të kësaj date.

6. Profesionisti ndaj të cilit është marrë një vendim për ndalim ose kufizim:

a) njoftohet me shkrim në të njëjtën kohë me dërgimin e sinjalizimit në sistemin IMI;

b) gëzon të drejtën për të paraqitur ankesë ose për të kërkuar korrigjim të informacionit sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin shqiptar;

c) ka të drejtë të kërkojë kompensim për çdo dëm të shkaktuar nga një sinjalizim i pasaktë ose i padrejtë

ç) në rast se vendimi është subjekt i procedurave gjyqësore ose administrative, kjo shënohet në sinjalizim.

7. Të dhënat në lidhje me sinjalizimin përpunohen dhe ruhen në sistemin IMI vetëm për aq kohë sa masa është në fuqi dhe fshihen brenda tre ditëve kalendarike nga data e shfuqizimit të vendimit përkatës ose nga data e përfundimit të masës.

8. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime të këtij neni kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 93

Akses qendror elektronik në informacion për profesionet e rregulluara

1. Nëpërmjet pikës së vetme të kontaktit të krijuar sipas legjislacionit për shërbimet, sigurohet publikimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i informacionit të mëposhtëm:

a) lista e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë të dhënat e kontaktit të autoriteteve kompetente përkatëse dhe të qendrës së asistencës sipas këtij ligji;

b) lista e profesioneve për të cilat është në dispozicion Karta Profesionale Evropiane, mënyra e funksionimit të saj, përfshirë tarifat që duhet të paguhet nga profesionistët, si dhe autoritetet përgjegjëse për lëshimin ose pranimin e saj;

c) lista e profesioneve për të cilat, në zbatim të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kompetent shqiptar kryen verifikimin paraprak të kualifikimeve profesionale përpara ofrimit për herë të parë të shërbimit;

ç) lista e programeve të arsimit dhe formimit të rregulluar ose të formimit profesional me strukturë të posaçme për ushtrimin e një profesioni të rregulluar, në kuptim të nenit 19, paragrafi 3, nënparagrafi b) të këtij ligji;

d) informacion mbi kërkesat dhe procedurat për ushtrimin e profesioneve të rregulluara, duke përfshirë:

i) deklarin paraprak sipas nenit 8 të këtij ligji,

ii) dokumentacionin e nevojshëm sipas nenit 68,

iii) procedurën për njohjen e kualifikimeve sipas nenit 67,

iv) kërkesat për njohuritë gjuhësorsipas nenit 75,

v) si dhe të gjitha tarifat që aplikohen;

dh) informacion mbi mënyrat e apelimit të vendimeve të marra nga autoritetet kompetente në zbatim të këtij ligji, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Informacioni i përcaktuar në paragrafin 1 publikohet në mënyrë të qartë, të plotë dhe të kuptueshme për përdoruesit, është i aksesueshëm në distancë dhe në mënyrë elektronike, dhe përditësohet në mënyrë të rregullt.

3. Çdo kërkesë për informacion, e adresuar te pika e vetme e kontaktit, merr përgjigje brenda afateve më të shkurtra të mundshme.

4. Ministria përgjegjëse për profesionet e rregulluara dhe pika e vetme e kontaktit marrin masa mbështetëse për të nxitur vënien në dispozicion të informacionit të përcaktuar në këtë nen

edhe në gjuhë të tjera zyrtare të Bashkimit Evropian, pa cenuar dispozitat kombëtare për përdorimin e gjuhës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

5. Ministria përgjegjëse për profesionet e rregulluara bashkëpunon me Komisionin Evropian dhe me shtetet anëtare për zbatimin e paragrafëve 1, 2 dhe 4 të këtij neni.

Neni 94

Procedurat me mjete elektronike

1. Autoritetet kompetente dhe pika e vetme e kontaktit sigurojnë që të gjitha kërkesat, procedurat dhe formalitetet që lidhen me njohjen e kualifikimeve profesionale dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara, sipas këtij ligji, të mund të përmbushen në mënyrë të lehtë, në distancë dhe përmes mjeteve elektronike.

2. Kjo dispozitë nuk pengon autoritetet kompetente që, në rast të dyshimeve të arsyetuara dhe vetëm kur është rreptësisht e nevojshme, të kërkojnë në një fazë të mëvonshme kopje të noterizuara ose të legalizuara të dokumenteve të paraqitura.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk zbatohen për zhvillimin e masave të kompensimit të përcaktuara në këtë ligj, përkatësisht periudhës së përshtatjes dhe testit të përshtatshmërisë.

4. Kur kërkohet në mënyrë të justifikuar përdorimi i nënshkrimit elektronik të avancuar, autoritetet kompetente pranojnë nënshkrime elektronike që përputhen me standardet teknike dhe formatet e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian, të cilat mundësojnë përpunimin ndërkufitar të dokumenteve të firmosura elektronikisht, në përputhje me legjislacionin shqiptar për nënshkrimin elektronik.

5. Të gjitha procedurat që zhvillohen përmes pikës së vetme të kontaktit ose pranë autoriteteve kompetente respektojnë parimet e përcaktuara në legjislacionin për shërbimet dhe aksesin elektronik të përdoruesve.

6. Afatet procedurale të përcaktuara në nenin 10 për verifikimin paraprak të kualifikimeve profesionale për ofrimin e përkohshëm të shërbimeve dhe në nenin 67 për procedurat për njohjen e kualifikimeve në kuadër të vendosjes, të këtij ligji, fillojnë nga momenti i dorëzimit të aplikimit të plotë ose të dokumenteve të munguar nga ana e profesionistit, përmes pikës së vetme të kontaktit ose drejtpërdrejt pranë autoritetit kompetent.

7. Kërkesa për kopje të noterizuara apo të legalizuara, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk konsiderohet si kërkesë për dokumentacion të munguar dhe nuk pezullon afatet procedurale.

Neni 95

Qendra e asistencës

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për profesionet e rregulluara, përcakton me vendim qendrën e asistencës për zbatimin e këtij ligji.

2.Qendra e asistencës është përgjegjëse për ofrimin e ndihmës dhe informacionit për shtetasit shqiptarë dhe për shtetasit e Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse, si dhe për qendrat homologe të asistencës në vendet e tyre.

3. Qendra e asistencës jep informacion dhe ndihmë lidhur me njohjen e kualifikimeve profesionale sipas këtij ligji, përfshirë: legjislacionin kombëtar që rregullon profesionet dhe mënyrat e ushtrimit të tyre, legjislacionin përkatës për mbrojtjen sociale, dhe rregullat e etikës profesionale, kur është e zbatueshme, si dhe bashkëpunon me qendrat e asistencës të vendeve të tjera pjesëmarrëse, me autoritetet kompetente dhe me pikën e vetme të kontaktit në Shqipëri, për të lehtësuar ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga ky ligj.

4.Autoritetet kompetente shqiptare janë të detyruara të bashkëpunojnë plotësisht me qendrën e asistencës në Republikën e Shqipërisë dhe, kur është e nevojshme, me qendrën homologe në shtetin e origjinës, duke u vënë në dispozicion këtyre qendrave të gjitha informacionet përkatëse mbi rastet individuale, me kusht që të respektohen dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5.Me kërkesë të Komisionit Evropian, qendra e asistencës informon këtë të fundit mbi rezultatet e trajtimit të rasteve me të cilat merret, brenda një afati jo më të gjatë se dy muaj nga data e marrjes së kërkesës.

6.Qendra e asistencës bashkëpunon me koordinatorin kombëtar për profesionet e rregulluara, si dhe me pikën e vetme të kontaktit, për të siguruar integritimin e informacionit dhe asistencës në mjetet elektronike të aksesit publik, sipas përcaktimeve të nenit 93 dhe nenit 94 të këtij ligji.

Neni 96

Transparenca, vlerësimi i kërkesave dhe shkëmbimi i informacionit mbi profesionet e rregulluara

1.Ministria përgjegjëse për profesionet e rregulluara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe koordinatorin kombëtar:

a) harton, administron dhe përditëson një bazë të dhënash kombëtare për profesionet e rregulluara, e cila përfshin:

- i) listën e profesioneve të rregulluara, së bashku me përshkrimin e veprimtarive përkatëse që ato përfshijnë;listën e arsimit dhe formimit të rregulluar ose me strukturë të posaçme sipas nenit 19, paragrafi 3, nënparagrafi b) ;
- ii) listën e arsimit dhe formimit të rregulluar ose të arsimit dhe formimit me strukturë të veçantë, sipas nenit 19, pika 3, shkronja “b”;
- iii) listën e profesioneve për të cilat kërkohet verifikimi paraprak i kualifikimeve, sipas nenit 10 të këtij ligji;

b) njofton Komisionin Evropian, pa vonesë të pajustificuar, për listat dhe çdo ndryshim të tyre, me qëllim përfshirjen e tyre në bazën e të dhënave të Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara;

c) për çdo profesion të përfshirë në listën e parashikuar në nënndarjen “a”, pika “iii”, përgatit dhe i paraqet Komisionit Evropian një arsyetim të posaçëm që shpjegon domosdoshmërinë e verifikimit paraprak të kualifikimeve profesionale.

2. Çdo kërkesë ekzistuese ose e re që kufizon aksesin ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, përfshirë përdorimin e titujve profesionalë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, i nënshtrohet një vlerësimi të proporcionalitetit, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) nuk është diskriminuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për shkak të shtetësisë ose vendbanimit;

b) justifikohet nga arsye detyruese të interesit publik;

c) është e përshtatshme për arritjen e objektivit të synuar dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për këtë qëllim.

3. Vlerësimi merr në konsideratë të gjitha masat e mundshme, përfshirë alternativat më pak kufizuese, të tilla si vetërregullimi, njoftimi paraprak ose masat jo të detyrueshme.

4. Për Për kërkesat që synohet të ruhen ose të miratohen rishtazi, ministria përgjegjëse garanton që:

a) ato shoqërohen me një arsyetim të qartë për përputhshmërinë e tyre me parimet e përcaktuara në pikën 2;

b) informacioni dhe arsyetimi i paraqiten Komisionit Evropian brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e kërkesës së re;

c) këto të dhëna regjistrohen në bazën e të dhënave kombëtare, për t’u transmetuar në bazën përkatese të të dhënave të Bashkimit Evropian, dhe bëhen publike;

ç) për çdo kërkesë të re, ministria përgatit një vlerësim të posaçëm të proporcionalitetit, bazuar në metodologjinë e miratuar sipas pikës 7 të këtij neni, i cili përfshin shqyrtimin e rrethanave kombëtare, objektivave legjitime dhe ndikimit në interesin publik dhe konkurrencën në treg.

5. Ministria përgjegjëse përgatit dhe i paraqet Komisionit Evropian, çdo dy vjet, një raport për kërkesat që janë hequr ose lehtësuar në kuadër të reformave në fushën e profesioneve të rregulluara.

6. Ministria përgjegjëse, nëpërmjet koordinatorit kombëtar, bashkëpunon me shtetet anëtare dhe Komisionin Evropian për shkëmbimin e informacionit mbi mënyrën e rregullimit të profesioneve dhe efektet e këtij rregullimi, si dhe përcakton autoritetin përgjegjës për transmetimin dhe marrjen e informacionit.

7. Nëse Komisioni Evropian ose shtetet anëtare paraqesin komente për kërkesat dhe arsyetimin e paraqitur nga ministria përgjegjëse, ato merren në konsideratë për qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të rregullimit të profesioneve.

8. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për profesionet e rregulluara, përcakton me vendim:

a) metodologjinë për vlerësimin e kërkesave në përputhje me këtë nen;

b) procedurat e koordinimit ndërinstitutional për përgatitjen e listave, arsyeve dhe raporteve;

- c) afatet për përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit;
- ç) detyrimet e raportimit dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të këtij neni.

Neni 97

Raportimi mbi zbatimin e këtij ligji

1.Ministria përgjegjëse për profesionet e rregulluara, në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe koordinatorin kombëtar, përgatit çdo dy vjet një raport mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe mbi funksionimin e përgjithshëm të sistemit të njohjes së kualifikimeve profesionale.

2. Raporti përmban, ndër të tjera:

a) të dhëna statistikore të detajuara për numrin dhe llojin e vendimeve të marra për njohjen e kualifikimeve profesionale, përfshirë rastet e aksesit të pjesshëm;

b) përshkrimin e çështjeve kryesore ose vështirësive të konstatuara gjatë zbatimit të këtij ligji;

c) analiza dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit të sistemit.

3.Të dhënat për raportin mbledhen nga autoritetet kompetente dhe sistemet elektronike përkatëse, përfshirë sistemi IMI dhe përpunohen nga koordinatori kombëtar.

4. Ne periudhën tranzitore deri ne anëtarësim, raporti përgatitet dorëzohet vullnetarisht Komisionit Evropian për qëllime të vlerësimit të përgatitjes dhe procesit të përafrimit.

5. Pas anëtarësimit, raporti dorëzohet pranë Komisionit në përputhje me afatet dhe kërkesat që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian.

TITULLI VIII

DISPOZITA TË TJERA DHE TË FUNDIT

Neni 98

Lista e profesioneve të rregulluara dhe vlerësimi i tyre

1. Këshilli i Ministrave miraton me vendim listën e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përkufizimin e parashikuar në nenin 3 të këtij ligji dhe sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Lista e profesioneve të rregulluara përmban për secilin profesion të paktën:

a) titullin profesional;

b) përshkrimin e profesionit;

c) organin kompetent përgjegjës për njohjen e kualifikimeve dhe dhënien e aksesit në profesion;

ç) mënyrën e ushtrimit të profesionit (me licencë, regjistrim, autorizim, etj.);

d) kërkesat specifike për kualifikim profesional ose masa kompensuese (nëse aplikohen).

3. Lista publikohet në një portal elektronik të aksesueshëm nga publiku dhe përditësohet në mënyrë të rregullt nga autoriteti përgjegjës.

4. Ministria përgjegjëse për koordinimin e politikave për njohjen e kualifikimeve profesionale bashkërendon me organet kompetente:

a) për të siguruar përditësimin, saktësinë dhe transparencën e të dhënave;

b) për të kryer vlerësimin periodik të nevojës për rregullimin e çdo profesioni në listë, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

5. Këshilli i Ministrave miraton me vendim procedurat për raportimin dhe vlerësimin e profesioneve të rregulluara, duke marrë në konsideratë zhvillimet në tregun e punës, praktikën e Bashkimit Evropian dhe rezultatet e konsultimeve me grupet e interesit.

Neni 99

Lista e profesioneve të rregulluara sipas nenit 3(2) të Direktivës 2005/36/EC

1. Profesioneve që ushtrohen nga anëtarë të shoqatave ose organizatave të njohura në mënyrë të veçantë nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, të cilat janë të përfshira në Aneksin I të Direktivës 2005/36/EC dhe që përmbushin funksionet sipas nenit 3, paragrafi 2, të saj, konsiderohen si profesione të rregulluara edhe për qëllimet e këtij ligji.

2. Lista e profesioneve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përditësohet sa herë që bëhen ndryshime në Aneksin I të Direktivës 2005/36/EC nga Komisioni Evropian.

Neni 100

Përditësimi i listave të veprimtarive

1. Ndryshimet e mundshme në listat e veprimtarive profesionale të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave të parashikuar në nenin 25, paragrafi 2, të këtij ligji, kryhen në përputhje me zhvillimet përkatëse në legjislacionin e Bashkimit Evropian.

2. Përditësimi i listave bëhet pa ndryshuar ndarjen ndërmjet Listës I, Listës II dhe Listës III, dhe pa ngushtuar fushën e veprimtarive të përfshira në secilën listë.

Neni 101

Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 102

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

KRYETAR

[-]

Miratuar më [-]